

VETERANI

GAZETË PERIODIKE

NR.2 (368)

SHKURT 2019

ÇMIMI: 30 LEKË

Kryeredaktor: Halil RAMA ; Zv/Kryeredaktor: Sakip Cami

Email: veterani.obvl@yahoo.com / website: www.VETERANIOBVL.ORG

DEKLARATA



Bashkimi kombëtar, porosi e Isa Boletinit

Thaçi: Bashkimi kombëtar dhe fuqizimi i kombit tonë ishte porosi që na e la Isa Boletini

FAQE 5

SPECIALE

Presidenti Meta nderon veprën e Ismail Qemalit

Misteri shekullor i vdekjes së Ismail Bej Vlorës



Nga
Ergys
ALUSHI

FAQE 6-7

HISTORIA



Marshimi heroik i tre batalioneve të Brigadës së I-rë Sulmuese

75 VJET MË PARË - Lufta Antifashiste, një ndër epokat më të ndritura në historinë e Shqipërisë

Ing. Myfit GUXHOLLI

FAQE 2

Zëvendësministri i Mbrojtjes Petro Koçi priti në një takim pune drejtuesit e OBVL

2019, viti i 75-vjetorit të çlirimit të Atdheut



100 VITE NGA HAPI I NDOJTUR I PAQES SË BOTËS

Albert VATAJ

Më 18 janar 1919 çeli punimet Konferenca e Paqes në Paris. Bota po hidhte kështu hapin e parë të ndrojtur të paqes. Historia po shkruante një nga faqet më të rëndësishme të civilizimit. Nevoja për paqe ishte më imediate se kurrë dhe kjo mundësi ishte nga më të mundimshmet. Por besimi te liria, të aspiratat e larta të humanizmit, të bashkëjetesës dhe reciprociteti do të gatitëtishin në një kopulim epik për të mbarsur në një shtatzani të vështirë vullnetin për paqe. Fati i botës do të shënojë në këtë konferencë një erë të re. E pamundura do të gjendej në rrugën e së mundshmes. Ethet e pushtetit dhe sunduesit e orekseve të pangopura duheshin urtuar. Të mëdhenjt duhet të pranonin se në këtë botë, nën këtë qiell ka vend edhe për fatin e të vegjëlve. Nerva të tendosura, dhëmbë të skërmitur, makinacione e dredhi zienin në havanin e këtij çasti sublim. Konferenca e Paqes

VJEON NE FAQEN 3

• Në pritjen e ngrohtë e miqësore me zv/Ministrin e Mbrojtjes, Petro Koçi, drejtuesit kryesorë të OBVL theksuan nevojën e krijimit të një komisioni të posaçëm shtetëror gjithëpërfshirës për programimin dhe organizimin e veprimtarive të këtij viti jubilar, si dhe me rastin e 100-vjetorit të lindjes të gjeneral Parllakut

FAQE 3

DOSSIER

A e ka ndihmuar Shqipëria Kosovën në vitet '80?!

FADIL HOXHA BISEDON ME ISHAM-BASADORIN SOKRAT PLAKA

Nga Sakip CAMI

FAQE 5

SESIONI JUBILAR

KONFERENCA E BUJANIT-VLERA QË DUHET TË JETËSOHEN

Nga Bashkim Hisari

FAQE 4

STUDIMI

Injac Zamputi mbi të vërtetën e mbytjes tragjike të PJETËR BUDIT

Nga Xhemal MEÇI

FAQE 3-9

PROFIL

PARTIZANI ADEM JAUPI – KAPITENI TRIM QË ÇAU DET EDHE OQEA NE

SHPENDI TOPOLLAJ FAQE 10

HOMAZH

LAMTUMIRË ZENEL MALIQ HOXHA

FAQE 12

SHËNDETI



KARDIOLOGU LEONIDHA PEPPO: KUJDESI QË DUHET TË KENI NGA I FTOHTI DHE SISTEMI KARDIOVASKULAR

FAQE 12

LIBRI


“RIZGJIME METEORËSH”, LIBRI I 13-TË I HALIL RAMËS

Një botim i ri me krijime të reja, të arrira artistikisht

Dr.Selman Meziu

FAQE 9

HALIL RAMA



RIZGJIME METEORËSH

HISTORIA

75 VJET MË PARË - Lufta Antifashiste, një ndër epokat më të ndritura në historinë e Shqipërisë

Marshimi heroik i tre batalioneve të Brigadës së I-rë Sulmuese



“Shtabi i Përgjithshëm nënvizon kujdesin e veçantë të komandës, e cila tok me batalionet e I-rë, II-të dhe të III-të të Brigadës së I-rë Sulmuese, pa marrë parasysh as lodhjen e as pengesat që mund të hasnin gjatë rrugës, por të bindur dhe të disiplinuar siç u ka hije partizanëve, të shtyrë nga dashuria e madhe për Atdheun, popullin dhe shtabin e Përgjithshëm, kanë vepruar për një pjesë të Komandës së Shtabit të Përgjithshëm, që ndodhej në zonat e rrezikshme dhe të përshkruara nga gjermanët e kolaboracionistët”



Inq. Myfit GUXHOLLI*

Në një kohë kur Operacioni i Madh i Dimrit 1943-1944 nuk kishte mbaruar akoma dhe për çudi, okupatorët nazistë gjermanë kishin deklaruar bashkë me kolaboracionistët, se UANÇL dhe lëvizja popullore që mbështeste këtë luftë kishin mbaruar, i gjeti këta të parët në befasi dhe të alarmuar. Ndërsa popullit i dha zemër dhe besim tek forcat partizane për një çlirim të plotë nga okupatori.

Marshimi luftarak nga Shqipëria e Jugut për në Shqipërinë e Mesme të tre batalioneve të Brigadës së I-rë Sulmuese u vendos nga Shtabi i Përgjithshëm i UANÇL.

Ky marshim u drejtua nga komandanti i Brigadës, Mehmet Shehu dhe u krye në kushte të vështira, në një dimër shumë të ashpër. Ata duhet të kalonin nëpër male të larta të mbuluara me dëborë, të veshur jo mirë dhe deri diku pa ushqime. Qëllimi ishte që forcat partizane, me një eksperience luftime më të mirë dhe luftëtarë nga të gjitha krahinat e Shqipërisë t'i çorientonin nazifashistët gjermanë e kolaboracionistët dhe të lehtësonin veprimet luftarake të qarkut të Elbasanit që manovronin në krahinat e Çermenikës, Shëngjergj e Martanesh dhe t'u vinin në ndihmë një pjesë të Shtabit të Përgjithshëm.

Me 21 shkurt 1944 forcat e Brigadës, pas luftimesh që kishin zhvilluar në Skrapar, u nisën nga Kapinova, kaluan në Qafë Dardhë, Opar, Gor dhe më 25 shkurt arritën në Çezmë të Mokrës (Malësi e Pogradecit). Sipas urdhrit të Komandantit të Brigadës, batalionet duhet të lëviznin të organizuara dhe me shpejtësi në mënyrë që të arrinin sa më parë dhe pa u zbuluar nga armiku në zemër të Çermenikës. Marshimi do bëhej drejt Qukës – Qarrishtës dhe Çermenikë - Shëng-

jergjit.

Me 26 shkurt të tre batalionet, nga Çezma e Mokrës, vazhduan marshimin e tyre të lavdishëm duke kryer luftimin në marshim për të thyer pritrat që armiku iu kishte përgatitur tre batalioneve, me synimin që t'i asgjësonte. Pikërisht duke pasur informacion, nazistët goditën forcat e Brigadës në një terren shumë të vështirë në fshatin Skroskë afër Qukës. Në këto luftime ndeshës, partizanët patën humbje disi të mëdha. Në vazhdim të marshimit forcat partizane treguan trimëri të rrallë. Duhej që patjetër të arrihej objektivi. Prita ishte në kodër të mbuluar me dëborë. Veç pozicionimit të favorshëm për armikun, aty mund të vinin dhe forca të tjera armike nga Librazhdi. Pas luftimesh të ashpra që bëri Batalioni i I-rë me armikun, forcave kryesore të Brigadës iu krijua mundësia të vazhdonin marshimin.

Urdhri ishte që forcat kryesore të mbështetnin njëra - tjetrën duke i dhënë mundësi forcave të batalionit të parë të bashkoheshin me ta.

Partizanët e Brigadës së I-rë zhvilluan luftime me forcat që kishin ardhur nga Librazhdi në fshatrat Velçan e Peshkur. Kundërgoditja e forcave të Brigadës i detyroi forcat armike gjermane të tërhiqeshin në bazën e nisjes mbi rrugën Librazhd-Qukës. Pas këtyre përpjekjeve, Komandanti i Brigadës u tregoi partizanëve për misionin që u

ishte ngarkuar tre batalioneve dhe kërkoi mendim rreth vendimit që u ishte ngarkuar, për të vazhduar ose jo marshimin. Përgjigja ishte një e vetme: “Të gjithë, të gjithë do të shkojmë. Rroftë Shtabi i Përgjithshëm!”. Ata shkuan përpara me guxim dhe vetëmohim e iu ngjiten përpjete malit të Shebenikut dhe më 28 shkurt arritën në kasollet e Dragoshtunit. Këtu pasi pushuan disa orë, ashtu siç ishin të pa ngrënë e pa gjumë, që nga data 26 shkurt, ata çanë rrugën në drejtim të Qarrishtës.

Gjermanët nazistë nuk hiqnin dorë nga shpartallimi i këtij marshimi të kësaj force ushtarake, e cila u hapi shumë punë në Shqipërinë e Mesme që ishte plotësisht nën diktatin e armikut.

Më 29 shkurt, 600 forca gjermano-naziste e kolaboracionistësh që i mbështesnin, goditën forcat partizane të Brigadës në Qarrishtë, ndërsa forcat armike të ardhura nga Librazhdi kishin zënë prita në të gjitha grykat në Lunik dhe donin t'u prisnin rrugën. Por ata luftuan me trimëri dhe heroizëm duke i shkaktuar armikut dëme të mëdha në njerëz, armatim dhe materiale të tjera. Ndërsa forcat partizane patën humbje të pakta, kaluan malin e Lëmit dhe zbritën me shpejtësi në rrugën Librazhd-Dibër dhe zunë katundin Llangë para se ta zinte armiku. Më pas vazhduan marshimin në drejtimin Llangë - Zabzun, Ok-

shtun e Kaptina e Martaneshit – Guri i Bardhë. Në tërësi të gjitha përpjekjet e armikut për të shpartalluar forcat e Brigadës dështuan. Pasi detyra e ngarkuar u arrit me një manovër të shkëlqyer, forcat partizane kryelartë se kryen një detyrë shumë të vështirë, kaluan në Qarkun e Tiranës e konkretisht në Pezën heroike.

Nga Peza forcat e Brigadës së I-rë Sulmuese përshkojnë krahinën e Pezës dhe kalojnë lumin Shkumbin, arrijnë në Dumre ku zunë robër 170 xhandarë dhe më 20 mars arritën në Sulovë. Fill mbas një muaji bashkohen me forcat e tjera të Brigadës së I-rë Sulmuese.

Ky marshim i tre batalioneve shkaktoi habi dhe panik në forcat e armikut dhe kolaboracionistëve. Për çudinë e marshimit të partizanëve, jepeshin informacione të pabesueshme nga ana armike: p.sh. se Mehmet Shehu me 500 veta ka hyrë në fshatin Rasë të Elbasanit. Po të njëjta informacione vinin nga Peqini e Berati, se Brigada e I-rë Sulmuese bashkë me forcat partizane të Pezës do sulmojnë Kavajën, Peqinin dhe si ka mundësi që ata të kalonin dhe lumin Shkumbin kur ai ishte i pakalueshëm.

Për këtë veprim ushtarak të shkëlqyer të kryer nga tre batalionet e Brigadës së I-rë Sulmuese dhe që bëri një jehonë të madhe në të gjithë vendin, Shtabi i Përgjithshëm i UANÇL i përgëzoi dhe ju dha fletë-lavdërimi në të cilën midis të tjerash thuhet: “Shtabi i Përgjithshëm nënvizon kujdesin e veçantë të komandës, e cila tok me batalionet e I-rë, II-të dhe të III-të të Brigadës së I-rë Sulmuese, pa marrë parasysh as lodhjen e as pengesat që mund të hasnin gjatë rrugës, por të bindur dhe të disiplinuar siç u ka hije partizanëve, të shtyrë nga dashuria e madhe për Atdheun, popullin dhe shtabin e Përgjithshëm, kanë vepruar për një pjesë të Komandës së Shtabit të Përgjithshëm, që ndodhej në zonat e rrezikshme dhe të përshkruara nga gjermanët e kolaboracionistët”.

***Nënkryetar i OBVL - Marrë nga arkivi i historisë ushtarake**

FOKUS

Zëvendësministri i Mbrojtjes Petro Koçi priti në një takim pune drejtuesit e OBVL

2019, viti i 75-vjetorit të çlirimit të Atdheut

•Në pritjen e ngrohtë e miqësore me zv/Ministrin e Mbrojtjes, Petro Koçi, drejtuesit kryesorë të OBVL theksuan nevojën e krijimit të një komisioni të posaçëm shtetëror gjithëpërfshirës për programimin dhe organizimin e veprimtarive të këtij viti jubilar, si dhe me rastin e 100-vjetorit të lindjes të gjeneral Parllakut

Organizata e Bashkuar e Veteranëve të LANÇI (OBVL) sjell në vëmendjen e opinionit publik dhe në mënyrë të veçantë, në vëmendjen qeverisë së Republikës së Shqipërisë faktin që viti 2019 është viti i 75-vjetorit të çlirimit të atdheut nga pushtuesit nazifashistë dhe bash-



këpunëtorët e tyre vendas. Në pritjen e ngrohtë e miqësore me zv/Ministrin e Mbrojtjes, Petro Koçi, drejtuesit kryesorë të OBVL theksuan nevojën e krijimit të një komisioni të posaçëm shtetëror gjithëpërfshirës. “OBVL kërkon që ky komision të jetë gjithëpërfshirës në dimensionet e vlerave që mbart dhe sjell 75-vjetori i çlirimit të atdheut, me qëllim që programimi i çdo detaji dhe festimi i këtij jubileu të jetë i denjë për këtë ngjarje të madhe, të jetë i denjë për të nderuar sakrificën sublime, gjakun e dëshmorëve, heroizmin e luftës partizane, e cila ishte dhe mbetet lufta më e madhe patriotike që ka zhvilluar populli shqiptar”. Kjo sipas nënkryetarit të OBVL, kolonel Myfit Guxholli, për fak-

tin se nderimi i 75-vjetorit të çlirimit të atdheut është padyshim një meritë për Shqipërinë evropiane, sepse në themel të Evropës së Bashkuar qëndrojnë vlerat e Luftës së Dytë Botërore. Zëvendësministri i Mbrojtjes, z.Koçi mirëkuptoi përfaqësuesit e OBVL, sipas të cilëve një çështje e veçantë që duhet të meritojë vëmendjen e qeverisë qëndrore dhe autoriteteve lokale të komunave dhe të bashkive, duhet të jetë rikonstruktimi i varrezave të dëshmorëve në të gjitha rrethet e vendit dhe gjithashtu rikonstruktimi i monumenteve të luftës antifashiste nacionalçlirimtare. Vëmendje të veçantë meriton përkujtimi i ngjarjeve që kanë shënuar dhe kanë bërë epokë aq më tepër po të kemi

parasysh që Lufta Nacionalçlirimtare e renditi Shqipërinë në krahun e koalicionit të madh antifashist botëror. Në këtë takim me zëvendësministrin e Mbrojtjes, z.Petro Koçi, drejtuesit e OBVL kërkuar gjithashtu mbështetje për vlerësimin e gjeneral Rrahman Parllakut në 100-vjetorin e ditëlindjes së tij. Shqipëria evropiane, Shqipëria e sotme është padyshim ëndrra e dëshmorëve të Luftës Nacionalçlirimtare, por që kjo ëndërr të jetë e realizuar në tërë dimensionin e saj qytetar dhe evropian duhet që këtë vit, pra vitin 2019, ta shndërrojmë në vitin e 75-vjetorit të çlirimit të atdheut, duke përmbushur të gjitha detyrimet që kemi ndaj qytetarëve shqiptarë.

NJE SHEKULL PAS

100 vite nga hapi i ndohtur i paqes së botës

Albert VATAJ

(vijon nga faqe 1)

e Parisit, e njohur ndryshe si Konferenca e Paqes e Versajës ishte takimi i Fuqive Aleate fituese pas fundit të Luftës së Parë Botërore. Duke përfshirë diplomatë nga 32 vende dhe kombësi, vendimet kryesore ishin krijimi i Lidhjes së Kombeve si dhe pesë traktatet e paqes me fuqitë humbëse; mandatimi i zotërimeve tejdutare të perandorive Gjermane dhe Osmane, kryesisht Britanisë dhe Francës; dhe ravijëzimi i kufijve të rinj kombëtar (në disa raste në formë plebishitare) duke pasqyruar më mirë ndarjet etnike. Rezultatit kryesor ishte Traktati i Versajës me Gjermaninë, i cili në seksionin 231 i ngarkonte fajësimin për luftën “Gjermanisë si dhe aleatëve të saj”.

MANIFESTIME TË SHQIPTARËVE PROAMERIKANË PRA NJË SHEKULLI
Europa e re, e cila doli nga Lufta e Parë Botërore, kërkonte edhe një rishikim të ri të kufijve të saj. Ballkani ishte padyshim i pari në kontekstin e ri. Austro-Hungaria dhe Gjermania, dy vendet që kishin ndihmuar Shqipërinë në Konferencën e Londrës, kishin dalë të humbura dhe



nuk ekzistonin më si perandori të fuqishme. Në skenën botërore kishte dalë SHBA-ja, fuqia e re që kishte qenë vendimtare në fitimin e luftës nga aleatet. Pikërisht tek kjo, u mbështeten shpresat e Shqipërisë për garantimin e kufijve të saj. Jugosllavia e porsa krijuar dhe Greqia kishin ngritur një sërë pretendimesh dhe nuk ishte çudi që kufijtë e 1913 të rrudheshin edhe më shumë. Aq më tepër, që Italia e cila kishte pushtuar Vlorën dhe rrethinat e saj, ishte e bindur për të mos i lëshuar ato. Delegacioni amerikan, me ndërhyrjen edhe të Vatikanit, kishte marrë përsipër mbrojtjen e Shqipërisë. Por dukej se edhe ai vete nuk ishte shumë i qarte. Për të pasur një tablo të plotë, delegacioni i kryesuar nga Presidenti ẽllson ngarkoi konsullin e SHBA-se në Torino, zotin Jozef Haven të bënte një vizitë në Shqipëri. Me letrën e rekomandimit në xhep dhe me një mandat të Konferencës së Paqes, Haven zbriti në Vlorë më 1919. Qeveria e Tiranës kishte caktuar për ta shoqëruar, Tefik Mborjen, Sekretar i Përgjithshëm i Kryeministrit dhe ish Ambasador i Shqipërisë në Romë. Mborja, i cili kishte pasur miqësi edhe më parë me Havenin, kreu një punë të mrekullueshme. Me të mbërritur në Vlorë, Haven hodhi poshtë ftesën e Gjeneral Piacentinit, komandantit italian të qytetit për të qëndruar tek ai. U vendos në shtëpinë e patriotit Qazim Kokoshi dhe më pas në shtëpinë e poetit Ali Asllani. Ai ra në kontakt me parinë e qytetit, e cila e bindi se nëse Italia nuk tërhiqej me dëshirë nga Vlorë, problemi do të shkonte në ndeshje të armatosur. Haven mbeti i befapsur nga niveli i intelektualëve vlonjate. Në italisht dhe anglisht, ata i ofruan atij një tablo të panjohur, por mjaft dinjitoze të vendit të tyre. Ai u befapsua sidomos kur një delegacion i grave të qytetit e siguroi në italisht, se ato do të luftonin bashkë me burrat nëse bëhej fjalë për të çliruar Vlorën. Konsulli u nis nga Vlorë në Tepelenë, ku me të mbërritur, filloi një demonstratë e madhe pro SHBA-së, të cilën ushtria italiane, që mbante qytetin nuk mund ta ndalonte. Haven thotë se ai asnjëherë nuk kishte parë kaq shumë flamuj të SHBA-së, të valëvitëshin me entuziazëm në erë. Nga Tepelena kaloi në Gjirokastrë, ku Kryetari i Bashkisë Javer Hurshiti, bashkë me Jorgji Meksin dhe Thoma Pa-

papanon, i bënë një pritje madhështore. Ai ishte në shtëpinë e Kryetarit të Bashkisë, kur e lajmëruan se jashtë ishte mbledhur gjithë populli i qytetit për ta përshëndetur. Një delegacion, i përbërë nga ish emigrantë në SHBA, erdhi për t'i sjellë mjaft dhurata dhe për ta përshëndetur në anglisht. Ai nuk kishte mbaruar ende me ta, kur një tjetër delegacion, i kryesuar nga Lame Kareco dhe Eftim Cako i kërkoi takim dhe deklaroi se Gjirokastra është tokë greke dhe dëshira e popullsisë se saj është një bashkim i shpejtë me Athinën. Kjo dërgate provokoi mërinë e popullit të mbledhur përpara shtëpisë së Kryetarit të Bashkisë dhe konsulli u bë dëshmitar i një mërie kolektive, që desh përfundoi me vrasjen e delegatëve pro grekë. Në Përmet, Leskovik dhe Kolonjë, konsulli amerikan u prit me nderime dhe me kërkesën që këto qytete të mbeteshin nën kontrollin e qeverisë së Tiranës. Problemi më i madh që në Korçë ku despoti Jakov dhe një elbasanas i quajtur Efem i bënë thirrje të gjithë të krishterëve të demonstrojnë për një bashkim me Greqinë. Por Haveni u vendos në shtëpinë e një misionari amerikan, të quajtur Kenedi, që e njëjti mjaft mirë qytetin. Kenedi e siguroi atë se Korça është thjeshtë shqiptare dhe këtë ja konfirmoi edhe Komandanti i trupave franceze të qytetit. Një konfirmim më të zjarrtë mori edhe nga komandanti francez në Pogradec, majori Mortier. Francezi i tha se gjithë popullsia aty ishte shqiptare dhe se shqiptarët janë një popullsi e mrekullueshme, aq sa atij i vinte keq që nuk ishte shqiptar. Pas një vizite po kaq të suksesshme në Vuno dhe Delvinë, ku u prit nga Leonidha Frashëri, Jozef Haven përpiloi pjesën e parë të raportit, atë për kufijtë e Jugut. Materiali u dërgua me urgjencë në Ambasadën amerikane në Romë dhe që këtej, brenda javës u vendos mbi tavolinën e punës së Ujllsonit në Versajë. Haven vazhdoi vizitën e tij në Durrës, Tiranë, Shkodër dhe Krujë ku gjeti po atë entuziazëm. Ai shoqërohej kudo nga Tefik Mborja, që duket se luajti një rol kyç. Raporti përfundimtar u hartua një muaj më pas dhe qe vendimtar për qëndrimin amerikan. Ujllsoni nuk pranoi asnjë korrigjim në kurriz të kufijve të Shqipërisë dhe u ngarkua Lidhja e Kombeve të përcaktonte kufijtë fizikë të saj. Tre muaj më vonë, qeveria e Athinës i paraqiti Uashingtonit një notë protes-

te, ku shënonte se Haveni ishte një njëri i blerë nga Shqiptarët.

PËRCAKTIMI I KUFIJVE

Komisioni i Lidhjes së Kombeve, që do të caktonte në vend kufijtë e Shqipërisë, mbërriti në Tiranë në një moment të trazuar. Me 7 dhjetor 1921, pikërisht ditën kur kishte bërë një grusht shteti dhe qe vendosur Qeveria e Hasan Prishtinës. Por, ata nuk morën vesh asgjë. Hasan Prishtina dha dorëheqjen pas 24 orësh dhe u zëvendësua nga kabineti i Xhaferr Ypit. Po atë ditë, i shoqëruar nga major Bajram Fevziu, Ministri i Brendshëm, komisioni udhëtoi për Shkodër. Ky ishte komisioni, që do të caktonte kufijtë e veriut dhe u detyrua të punonte me ndërprerje për më shumë se një vit. Ai kryesohej nga një kolonel Francez dhe një major Holandez. Një vit e gjysëm më pas, më 1923 mbërriti komisioni që do të caktonte kufijtë e Shqipërisë së Jugut. Ai kryesohej nga gjenerali Telini, një oficer i Mbretërisë Italiane dhe nga një major britanik. Edhe kësaj here komisioni shoqërohej nga Bajram Fevziu, kësaj here Shefi i Shtabit të Përgjithshëm dhe deputet i Kolonjës. Komisioni punoi për gati tetë muaj dhe ai kishte udhëzim që të vendoste me iniciative vijën e kufirit me ato fshatra, që duhej të ndaheshin më dysh. Për të mos rënë pre e pretendimeve, komisioni kreu një test të thjeshtë. Ata mbushnin një grusht me monedha dhe ja hidhnin fëmijëve të fshatit. Fëmijët fillonin të shanin në gjuhen e tyre të përditshme, e cila ishte në masën më të madhe, shqipja. Kështu, mjaft fshatra kufitare, iu bashkuan Shqipërisë. Me sa duket kjo provokoi merinë e grekëve që veç ankimeve sulmuan disa herë edhe komisionin dhe xhandarët që e shoqëronin. Në një nga këto pritë, Gjeneral Telini u godit në kokë dhe vdiq në vend. Vrasja e tij shkaktoi incidente të rënda mes Italisë dhe Greqisë. Flota italiane bombardoi dhe pushtoi Korfuzin. Ajo u largua prej andej, vetëm pas bisedimeve në Paris, të cilat i jepnin dorë të lire Italisë në Greqi. Shqyrtimi i kufijve të mëtejshëm të Shqipërisë së Jugut mbeti pezull, derisa u caktua në bisedime shqiptaro-greke më 1927. Trupi i Gjeneral Telinit u dërgua në Tiranë ku ju bënë gjithë nderimet ushtarake. Prej këtej u nis në Itali. Fati e solli që në emër të Qeverisë së Tiranës ai u përroll nga Mehmet Konica, njeriu i parë që kishte luftuar për kufijtë e Shqipërisë dhe që tani, po e mbyllte kapitullin e tyre, duke i bërë nderimet e fundit, njëherë prej mijëra viktimeve të këtij konflikti.

NDERIMI

Presidenti Meta nderon veprën dhe kujtimin e themeluesit të shtetit modern shqiptar, Ismail Qemali



Presidenti i Republikës, Sh. T. Z. Ilir Meta nderoi më 24 Janar 2019 veprën dhe kujtimin e atdhetarit Ismail Qemali, me rastin e 100-vjetorit të ndarjes nga jeta. Pasi u përul me respekt para shtatores së burrit të madh të kombit që shpalli pavarësinë e Shqipërisë në 1912 në Vlorë duke themeluar shtetit modern shqiptar, Presidenti Meta vendosi një buqetë me lule duke nderuar veprën e Tij të ndritur. Në prani të përfaqësuesve të mediave, Presidenti i Republikës u shpreh: “Ju falënderoj që keni gjetur kohën për të shoqëruar këtë moment, të përuljes përpara shta-

tores të themeluesit të shtetit tonë modern dhe Atit të Shqipërisë, Ismail Qemalit në këtë 100-vjetor të kalimit të tij në përjetësi, për shkak të veprës së tij të ndritur që ai me shumë patriotë të tjerë realizuan më 28 Nëntor të vitit 1912!

Sot është momenti jo vetëm të përulemi përpara veprës së tij, por edhe të angazhohemi për forcimin e shtetit shqiptar për ruajtjen dhe lartësimin e simboleve tona kombëtare, por njëkohësisht edhe për përmbushjen e ëndrrës së tyre për një Shqipëri plotësisht europiane”, – u shpreh Presidenti Meta.

75-vjetori: Akademi përkujtimore në qytetin e Bajram Currit, organizuar nga organizatat e veteranëve të LANÇ të Kosovës dhe Shqipërisë

KONFERENCA E BUJANIT-VLERA QË DUHET TË JETËSOHEN

• Konferenca e Bujanit, zë një vend të veçant në historinë e re shqiptare si një afirmim i fuqishëm i identitetit politik të Kosovës dhe i vullnetit të popullit të saj mbi të drejtën e vetëvendosjes për bashkim kombëtar

Nga Bashkim Hisari

Konferenca e Bujanit paraqet një nga ngjarjet më të mëdha në historinë e kombit shqiptar. Edhe pse ka qenë vazhdim i natyrshëm i Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe ka marrë vendime të drejta, të argumentuara e me parime të qarta e të përcaktuara mirë, ato kanë qenë objekt i vlerësimeve të ndryshme, të mohimeve, ndëshkimeve dhe paradigmeve politikë, që kanë pasur pasoja në zhvillimin e mëvonshëm të historisë më të re të Kosovës.

Viteve të fundit për Konferencën e Bujanit nuk ka më përplasje, vlersime diverse, kritika, heshtje si më parë. Ajo po vlersohet objektivisht, kurse dëshirat dhe kërkesa për bashkim kombëtar po bëhen më të shprehura dhe më transparente. Kjo u dëshmuar edhe në aktivitetet që u organizuan në fund të muajt dhjetor të vitit të kaluar dhe në fillim të janarit të këtij viti, në Gjakovë, Malësinë e Gjakovës, Bajram Curr, Prishtinë, me rastin e shënimit të 75 vjetorit të Konferencës.

Konferenca e Bujanit u organizua kur populli i Kosovës u mështua në luftën antifashiste nacionalçlirimtare me rreth 53.000 luftëtarë (6.200 ranë dëshmorë) të cilët luftuan krah për krah me veteranët antifashist të Shqipërisë e të botës tjetër përparimtare, dolën fitues. Në të njëjtën kohë, afirmuan të drejtën e tyre për vetëvendosje, dhe dëshirën e kahershme e të vazhdueshme për t'u bashkuar me Shqipërinë.

Me pjesëmarrjen e të gjitha shtresave shqërore, duke përfshirë edhe pakicat kombëtare të Kosovës, në Konferencën e Bujanit u miratuan vendime politike për të drejtën e popullit shqiptarë për bashkim kombëtar, bashkim me Shqipërinë dhe mobilizim për qëllime universale.

Në Bujan u përçua fuqishëm zëri i përfaqësuesve të popullit, personaliteteve ushtarake-politike, intelektualëve dhe patriotëve nga Kosova e Shqipëria, për afirmimin e identitetit politik dhe vullnetit të popullit të Kosovës mbi të drejtën e vetëvendosjes-për bashkim kombëtar.

Në Konferencën e Bujanit u formuan bërthamat e pushtetit që pretendonin të ishin popullore e të zgjedhura drejtpërdrejt dhe në mënyrë demokratike prej vet popullit, duke filluar nga Këshilli Nacionalçlirimtar të Kosovës dhe Rrafshit të Dugagjint e Kryesia e tij, që duhej të kishin funksionin e Parlamentit dhe të Qeverisë së përkohshme të Kosovës.

Objektivisht, vendimet e Bujanit, mbetën fakte të argumentuara dhe të rëndësishme që fuqizuan dhe afirmuan të drejtën për vetëvendosje dhe gjatë 75 viteve të ndërluara u bënë preveranca kryesore e popullit të Kosovës.

Këto konstatime dominuan në Akademinë përkujtimore në qytetin e Bajram Currit, organizuar nga organizatat e veteranëve të LANÇ të Kosovës dhe Shqipërisë, në Tryezën e Lëvizjes së Vetëvendosjes në Prishtinë, në Konferencën e intelektualëve “Jakova” në Gjakovë dhe në aktivitetet tjera, ku morrën pjesë veteranët dhe



pasardhësit e tyre, antarët e Organizatës së veteranëve të LANÇ të rrethit të Tropojës, Kryesisë së Organizatës së Veteranëve të LANÇ të Kosovës dhe degëve të saj në Gjakovë, Prishtinë, Prizren e Pejë, kryetari i veteranëve të Tropojës, Rexhep Shpati, Prefekti i Qarkut të Kukësit, Zenel Kuçani, kryetar i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, Akademikët Jusuf Bajraktari dhe Minir Dushi, diplomati dhe historiani i shquar Pëllumb Xufti, historianët Akif Bajrami dhe Dorian Koci, deputetët në Kuvendin e Kosovës, Flora Brovina, Arbërie Nagavci, Sami Kurteshi, Ismail Kurteshi, kryetari i Shoqatës së të Burgosurëve politik Hidalet Huseni, përfaqësues të Shoqatës së intelektualëve “Jakova”, dhe shumë personalitete tjerë të njohur në jetën publike nga Shqipëria dhe Kosova.

Gjatë periudhës së vështirë shumëvjeçare deri në luftën e drejtë të popullit të Kosovës udhëhequr nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK-së) 1998/99, dhe intervenimin e aleancës ushtarake më të fuqishme në botë – NATO-s që u vu në mbështetje e të mbrojtjes së vlerave më të larta të civilizimit perëndimor në Kosovë, lirisë, paqes dhe demokracisë, popullit shqiptar të Kosovës jo vetëm që i është mohuar dëshira e kahershme dhe e vazhdueshme për t'u bashkuar me Shqipërinë, por ai ishte edhe i shtypur në pikëpamje politike, nacionale dhe ekonomike dhe shqiptarët ishin destinuar edhe për shfarosje. Konferenca e Bujanit, zë një vend të veçant në historinë e re shqiptare si një afirmim i fuqishëm i identitetit politik të Kosovës dhe i vullnetit të popullit të saj mbi të drejtën e vetëvendosjes për bashkim kombëtar. Pavarësisht se bashkimi me Shqipërinë ishte vullneti i popullit dhe faktit se Kosova arriti të çlirohet nga okupatori fashist, vendimet e Bujanit nuk u respektuan, u kufizuan dhe eliminuan. Udhëheqja jugosllave me egërsi përdori të gjitha mjetet për të shkelur vendimet e Bujanit dhe parimet e të drejtës për vetëvendosje. Pas Luftës së Dytë Botërore, Kosova, faktikisht u ripushtua, u aneksua dhe u ngrit një “mur” i ndarjeve të shqiptarëve prej shqiptarëve. Në Kosovë u vendos pushteti ushtarak. Krerët e Kosovës në krye me Fadil Hoxhën, i cili mbronte Konferencën e Bujanit dhe kundërshtonte udhëheqësit serbë e jugosllavë që e quanin Konferencën separatiste, u ftuan në Beograd për “konsultime”-për fatin e Kosovës, a të ndahej si në kohën e Jugosllavisë monarkiste (banovina) apo të mbetej brenda kufijve të

tri njësi federale: Serbisë, Malit të Zi e Maqedonisë, brenda kufijve që do t'i caktonte një komision i drejtuar nga antari i Byros Politike të KQ të PKJ, Millovan Gjillas, i cili qortonte dhe dënonte vendimet e Konferencës duke thënë se Kuvendi i Bujanit “nuk mundet të jetë institucion ligjvënës”. Ata delegatë që patën guximin të deklaroheshin për bashkimin e Kosovës me Shqipërinë, u ndoqën dhe u persekutuan. Disa prej tyre u vranë në kohën e luftës si Xhevdet Doda, Hajdar Dushi...disa u vranë pas luftës: Xheladin Hana, Rifat Berisha, Halim Spahija ose u internuan si Qamil Luzha dhe u depurtuan nga Kosova si Zekeria Rexha.

Pas luftës, karshi Konferencës së Bujanit, serbët janë treguar në një gjendje të mendjes së turbulluar shoviniste. Zbatonin teorinë dhe politikën nacionaliste reaksionare dhe pretendonin, në kurriz të shqiptarëve, të krijojnë Serbinë e Madhe. Vendimet e Bujanit i kundërshtonin me urrejtje. Në këtë fushatë të egër kanë qenë të kyqur institucionet, politikanë, historianë, kisha ortodokse serbe, Akademia e shkencave, diplomatë, shkrimtarë, gazetarë dhe serbët e manipuluar nga Kosova. Shqiptarët e Kosovës u nënshtroheshin masave të shumta të dhunës, dëbimeve e shpërnguljeve, ndërrimit të disaheqësive të pronave, kolonizimit të trojeve të tyre, ndryshimeve të përsëritshme të statusit dhe këto, radikalizoheshin gjithnjë e më shumë. Mbeten të përhershme kujtimet e hidhura kur Millosheviq uzurpoi me dhunë pushtetin, dhe kur organizoheshin mitingje e protesta antidemokratike anë e mbanë Jugosllavisë, dhe serbët kërkonin dorëheqjen e udhëheqësve kosovarë duke brohoritur parulla si: “Duam liri”, “Duam armë”, “Ne jemi armatë”, “Kosova është Serbi”, “Të thirrën rusët”, “Të vritet Fadil Hoxha dhe të vihet mbi hu” e shumë parulla të tjera ofenduese e nënçmuese kundër shqiptarëve. Fadil Hoxha akuzohej si strateg për Shqipërinë e Madhe i cili siç thonin, qysh në vitin 1944 në llogari të pjesëve të Jugosllavisë dhe në dëm të jetës së serbëve paska formuar rreth të fortë për zbatimin e vendimeve të Bujanit. Fadil Hoxha kundërshtonte ashpër serbët që kërkonin që shqiptarëve t’u merren të drejtat për ç’arsye akuzohej si armik i serbëve, jo rastësisht sepse me nismën e tij u organizua dhe u mbajt Konferenca e Bujanit. Andaj, udhëheqja partiake jugosllave e ngriti komisionin e veçantë për përcaktimin e përgjegjësisë së tij. Spekullonin



se shqiptarët gjatë okupacionit kanë qenë në anën e fashizmit dhe kërkonin që shqiptarëve t’u hiqen të drejtat që kishin fituar në periudhën pas Luftës së Dytë Botërore e posaçërisht ato të drejta që ishin të garantuara me Kushtetutën e vitit 1974. Nga mesi i viteve 80-ta Fadil Hoxha shkarkohet nga të gjitha postet, kurse më vitin 1991, regjimi i Millosheviqit lëshoi aktgjykim dhe inskenoi procesin gjyqësor me akuzat të kurdisura, e poashtu edhe procedura për marrjen e gradave të luftës.

Demoni i nacionalizmit serb, Slobodan Millosheviq, ka bërë gjithçka për të flakur synimet e popullit shqiptarë për shkëputjen e Kosovës nga Jugosllavia dhe bashkimin me Shqipërinë. Ka zbatuar politikën e represionit, dhunës, krimin, politikën e shtypjes së të drejtave themelore të njeriut, dëbimeve, abuzimeve, heqjen e institucioneve, ndalimin e përdorimit të gjuhës, shkolllimit deri te politikën e varreve masive. Gjatë konfliktit të viteve 1998-1999 në Kosovë, forcat serbe, ushtria, policia dhe formacionet paraushtarake, të ndihmuara edhe nga serbët lokal, kanë vrarë me qindëra fëmijë, pleqë, gra dhe burra shqiptarë të pafajshëm dhe të paarmatosur. Kanë dhunuar rreth 20 mijë vajza e gra. Mbi 170.000 shtëpi dhe objekte tjera plotësisht janë djegur dhe shkatërruar kurse afro një milionë shqiptarë, me dhunë janë dëbuar nga vendlindja e tyre. Dëmet matrijale vlersohen të jenë rreth 22 miliardë euro. Në varrezat masive nëpër Serbi ende nuk janë zbuluar të gjithë trupat e pajetë të shqiptarëve të vrarë.

Fatëkeqësisht, krerët politik aktualë të Serbisë, Vuçiç, Daçiç, Vulin, kryeqetrniku Sheshel dhe shumë të tjerë, kryesisht bashkëpunëtorë të politikës së Millosheviqit, sot po shtirën sikur Konferenca e Bujanit dhe lufta e UÇK-së për liri e pavarësi nuk ka ndodhur. Në vend që të thonë se si qëndrojnë gjërat me të vërtetë dhe të pranojnë përgjegjësinë për atë që bënë, ata çirren sa kanë fuqi dhe mburren me realitetin profashist që në Serbi e kanë krijuar vetë.

Konferenca e Bujanit është kujtesë për gjithë brezat shqiptare, vendimet e saj janë me plotë vlera që nuk duhet harruar, janë qëllime të larta të mbështetura në bindjen e popullit dhe përbëjnë pikësynimet kryesore që duhet ruajtur, zhvilluar dhe jetësua

DEKLARATA

Thaçi: Bashkimi kombëtar dhe fuqizimi i kombit tonë ishte porosia që na e la Isa Boletini

Bashkimi kombëtar, porosi e Isa Boletinit

Më 23 janar u bënë 103 vjet që nga vrasja e Isa Boletinit, njërit nga udhëheqësit kryesorë të kryengritjeve shqiptare, ndërsa në nder të këtij vjetori, presidenti i Kosovës Hashim Thaçi ka shkruar një dedikim. Ai ka përmendur edhe porosinë që Isa Boletini ka lënë për çlirimin e trojeve etnike shqiptare. "U bënë 103 vjet nga vrasja e Isa Boletinit, njërit prej udhëheqësve kryesorë të kryengritjeve shqiptare. Bashkimi kombëtar dhe fuqizimi i kombit tonë ishte porosia që na e la Isa Boletini. Përpjekjet e tij një shekull më parë për çlirimin e trojeve etnike përbëjnë ende frymëzim për shumë breza të rinj dhe amaneti i Isa Boletinit dhe patriotëve të tjerë, që dhanë jetën për bashkimin e shqiptarëve, na obligon edhe sot që të punojmë pareshtur për përmbytjen e aspiratave tona", ka shkruar Thaçi.

Isa Boletini lindi në kullën e Boletinëve, afër Mitrovicës, më 15 janar 1864. Vitet e rinisë i kaloi në vendlind-



je. Në prill të 1881 mori pjesë në betejën e Shlivovës, ku u ndeshën trupat e

Lidhjes Shqiptare të Prizrenit me ushtrinë osmane.

Në nëntor 1908, Porta e Lartë dërgoi një ushtri prej 7 mijë ushtarësh për të nënshtruar Kosovën. Komandën e qëndresës antiosmane e mori në dorë Isa Boletini. Gjatë tërheqjes, osmanët i dogjën kullën në shenjë hakmarrjeje. Gjatë vitit 1909, Isa Boletini udhëhoqi kryengritjet e kosovarëve në Prishtinë, Prizren e gjetiu. Ishte një ndër udhëheqësit më kryesorë të kryengritjes së pranverës 1910. Nën drejtimin e tij, shqiptarët bllokuan për dy ditë në betejën e përgjakshme të Carralevës ushtritë osmane që po depërtonin në Kosovë.

Gjatë Luftës Ballkanike të 1912-s, ishte një ndër kryetarët më në zë të çetave në Kosovë. Në nëntor 1912, u vu menjëherë në mbrojtje të qeverisë së parë shqiptare, asaj të Ismail Qemalit. Ishte anëtar i delegacionit shqiptar që shkoi në Londër për të mbrojtur ekzistencën e Shqipërisë së porsakrijuar. Në 1914 trupat e tij mbrojtën qeverinë

e Princ Vedit.

"Baca Isë" është bërë i njohur edhe për ndodhinë që i ngjau në Londër. Teksa delegacioni shqiptar shkonte të takonte Eduard Grejin, ministër i Jashtëm asokohe i Mbretërisë, roja i kërkoi Isait me xhentesë që të dorëzonte revolverin. Isai u bind pa fjalë. Pas bisedimeve Grej, si një anglez i vërtetë bëri shaka: Nesër gazetatat do të shkruajnë se atë që nuk e bëri dot ushtria e pamat osmane, e bëra unë. Isa Boletini u çarmatos vetëm në Londër! Thonë se Isai është përgjigjur: Jo besa, as në Londër! Dhe ka nxjerrë një tjetër revolver që e mbante diku fshehur.

Isa Boletini u vra bashkë me shtatë nga njerëzit e tij në Podgoricë, mbi Urën e Moraçës, më 23 janar 1916.

Fakti që postimi i Presidentit të Kosovës vjen në një kohë të trazuar për Ballkanin që lundron në debatin për korigjim kufijsh, do të thotë se një mesazh i koduar fshihet dhe me shumë gjasë mund t'i drejtohet Serbisë.

DOSSIER

Nga biseda e ambasadorit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë në Beograd, Sokrat Plaka me liderin e Kosovës në vitet -80, Fadil Hoxha

A e ka ndihmuar Shqipëria Kosovën në vitet '80?!

FADIL HOXHA BISEDON ME ISH AMBASADORIN SOKRAT PLAKA: "VAZHDONI TË NAMBËSHTETNI JO VETËM NË FUSHËN E ARSIMIT, KULTURËS DHE SHKENCËS, POR EDHE NË FUSHËN EKONOMIKE"



...Fadilin e takoj për herë të tretë nëpër pritje. Dy herët e para bisedën na e kanë ndërprerë funksionarët e protokollit dhe nuk na kanë lënë të bisedojmë. Këtë rradhë biseduam lirisht, në këmbë, në pritje dhe mbase kjo mund të jetë një arsye që Fadili foli më gjatë. Biseda ishte e qetë dhe ai vetë donte të fliste. Kur vinte ndonjë personalitet për t'u takuar, bisedën e kalonte menjëherë nga temat e Kosovës në marrëdhëniet midis dy vendeve.

Kështu shkruan ambasadori i Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë në Beograd, Sokrat Plaka në informacionin që i dërgon MPJ të Shqipërisë në datën 1 dhjetor 1980. (Shih faksimilen e AQSH)

Kryesisht Fadili preku tre çështje:

- Mardhëniet kulturore, arsimore dhe shkencore të Kosovës me Shqipërinë po ecin mirë, po shkojnë përpara dhe të vazhdojmë kështu sepse është mirë. Vizita e ministres së arsimit Tefta Cami në Kosovë përfundoi me sukses. Tani duhet të zhvillohen edhe marrëdhëniet ekonomike.


Mendoj se e ka mirë, sugjeron ambasadori Plaka në relacionin e tij drejtuar MPJSH sepse ekonomia siguron unitetin kombëtar të kombit.

Ne kemi qenë bashkë gjatë sundimit turk, vazhdon bisedën Fadili, pastaj na ndanë e kështu kemi dhjetra vjet, koha ka bërë punën e vet, prandaj është e nevojshme të forcohen lidhjet midis atdheut amë dhe popullsisë shqiptare në Kosovë dhe në viset e tjera. Ne këtu në Jugosllavi deri më 1963, kur Kosova ishte nën Serbi nuk ishim mirë, kurse që nga ajo kohë rifirmimi kombëtar i popullsisë shqiptare ka ecur.

Detyra jonë kryesore këtu është të formojmë ndërgjegjen kombëtare të shqiptarëve dhe në këtë proces kemi nevojë të madhe për përkrahjen e Shqipërisë, për përkrahjen e saj morale dhe të gjithanshme. Procesi i rifirmimit kombëtar të shqiptarëve në Jugosllavi, edhe tani pas Titos do të vazhdojë. Kjo tani nuk mund të kthehet mbrapsht.

Në të vërtetë kontaktet e popullsisë së Kosovës me Shqipërinë filluan në vitin 1971. Deri në atë kohë nuk lejoheshin kosovarët të shkonin në Shqipëri. Kjo u bë e mundur vetëm pas takimit tim me Titon.

- Mendoj, theksoi Fadili që mardhëniet midis dy shteteve, Shqipërisë dhe Jugosllavisë të jenë vazhdimisht korrekte dhe të mira sepse çdo përkeqësim i tyre ndikon në Kosovë dhe në viset e tjera shqiptare dhe anasjelltas marrëdhëniet e mira ndikojnë tek ne. Në një mbledhje të Shtabit të Përgjithsëhm të ushtrisë jugosllave,



ku para disa vjetësh merrja pjesë edhe unë, Tito u bëri vërejtje gjeneralëve që në ndonjë rast agresioni, Shqipërinë të mos e konsideronin armik, por aleat, sepse shqiptarët nuk luftojnë kundër shqiptarëve.

- Fadili sugjeroi që vizitat ndërshtetërore të kalonin në nivele të larta ndërshtetërore, pavarësisht pikpamjeve ideologjike dhe politike sepse ka çështje me interes të përbashkët.

Në kushtet e Jugosllavisë, ne shqiptarët mundëm të bëjmë kaq sa bëmë. Le të na gjykojë koha Unë do t'i heq kapelen me kënaqësi kujtdo që do ta bënte detyrën tonë këtu më mirë se sa e kam bërë unë dhe shokët e mij dhe do të ja lija me gjithë qejf pozitën time.

Sot në Kosovë ka 50 mijë studentë, nga të cilët 37 mijë shqiptarë, gjë që as që mund të imagjinohej 30 vite më

parë. ...Për 10 vjet shqiptarët do të jenë kombi i tretë në Jugosllavi për nga numri i popullsisë. Kur u shpallën rezultatet e regjistrimit të popullsisë në vitin 1971 më thirri Tito, nënvizon Fadil Hoxha dhe më tha se në Kosovë janë bërë fallsifikime të regjistrimit të popullsisë në favor të popullsisë shqiptare. Kjo nuk është e vërtetë, i thashë Titos, sepse në krye të Komitetit të Regjistrimit në Kosovë ishte serbi Ilia Vakiçi. Kështu u hodhën poshtë ankimet dhe kërkesat për reregjistrim në Kosovë.

Pothuajse gjatë gjithë bisedës, informon ambasadori Plaka, Fadili vinte theksin në vështirësitë që kishin dhe në ndihmën që kërkonin nga Shqipëria.

Përgatiti: Sakip Cami

SPECIALE

Në 100-vjetorin e vdekjes të Babait të Pavarësisë së Shqipërisë

Misteri shekullor i vdekjes së Ismail Bej Vlorës

Përpyekjet e udhëtimit në SHBA, Konferenca e Pagues dhe misteri shekullor i vdekjes në Itali

Nga Ergys Alushi

- **Misteri shekullor i vdekjes së Ismail Bej Vlorës! -Vdekje natyrale apo e helmuan?!**
- **Përpyekjet e Ismail Qemalit për vajtjen në Shtetet e Bashkuara dhe Konferencën e Pagues në Paris. Vdekja e papritur në moshën 75-vjeçare në hotelin "Brufani" të Peruxhias. Interesi i italianëve për vdekjen e Ismail Bej Vlorës**
- **Në 100-vjetorin e vdekjes së vlonjatit që Shpalli Pavarësinë e Shqipërisë**
- **Po nëse e helmuan, përse e donin të vdekur?**
- **Çfarë do të deklaronte Ismail Bej Vlorë në konferencën për shtyp?**
- **Çfarë kishte bërë dhe çfarë dinte ai më shumë se të tjerët që duhet të vdiste?**
- **Kush ishin të interesuar për vdekjen e tij, italianët apo kundërshtarët e tij shqiptarë?**
- **Për çfarë ishte bërë pengesë vlonjati që kishte shpallur Pavarësinë e Shqipërisë?**
- **Përse iu vonua ndihma mjekësore dhe a pati një autopsy për të gjetur shkaqet zyrtare të vdekjes së tij?**
- **A janë të vërteta fjalët e djalit të pronarit të hotelit në të cilin vdiq Ismail Bej Vlorë se i kishte mbetur peng vdekja e plakut nga Shqipëria?**
- **Përse nuk është hetuar asnjëherë zyrtarisht edhe nga shteti shqiptar në këto 100 vjet për vdekjen e kryeministrit të parë të Shqipërisë?**



përfaqësues në Konferencën e Pagues në Paris.

NGA MADRIDIN NË ITALI

Por, ndërsa të hollat që i duheshin për të shkuar në Amerikë e prej andej në Paris, nuk erdhën kurrë në ambasadën Amerikane në Madrid, Ismail Bej Vlorë vendosi të shkonte në Romë të Italisë. Kryeministri i Italisë Vittorio Emanuele Orlando ishte një ndër liderët e shtetit fqinj që i kishte premtuar se do e ndihmonte për të shkuar në Paris, për të mbrojtur çështjen e Shqipërisë ashtu si kishte bërë një jetë të tërë. Por, zhgënjimi i vlonjatit do të ishte madh kur mësoi se kryeministri Italian ishte larguar për jashtë shtetit dhe nuk e kishte pritur ashtu si i kishte premtuar. Zhgënjimin e Ismail Bej Vlorës e jep gazetari i "Times", Eilham Fullerton kur shkruan: "Plaku i gjorë ishte simbol i zhgënjimit që i priste 50 popuj të ardhur me vrap në Paris, sikur po vinin në Mekë". Ndërkohë vetëm pak ditë para se të ndërronte jetë ai do të shkruante në një letër "Sot është dita vendimtare e Shqipërisë, do të ngjallemi apo do të vdesim. Unë e dua Shqipërinë nën regjimin demokrat e federal për popullin shqiptar". I zhgënjyer nga liderët Italian dhe vetë kryeministri i Italisë, Ismail Bej Vlorë do të vendoste të jepte një konferencë shtypi në hollin e hotelit "Brufani" në Peruxhia.

Vdekja e papritur e Ismail Qemalit ishte 75 vjeç, por gëzonte një shëndet të mirë, një mendje të kthjellët. Vuante nga sëmundja e parkinsonit, por edhe kjo nuk e pengonte që të ishte aktiv në punët e Shqipërisë. Para se të dilte para gazetarëve, piu një kafe, ndoshta për të mbledhur veten.

Ja si e ka treguar tek Ali Asllani, kryetar i bashkisë së Vlorës, vdekjen e babait të vet, Et'hem Beu, djali i Ismail Bej Vlorës, që ka qenë duke shoqëruar babanë në Itali bashkë me Luigi Gurakuqin "Një ditë i përgatitën babait një konferencë për gazetarët. Pas buke ai hyri në sallën ku e prisnin korrespondentët. Që në fjalitë e para të bisedës, i zverdhur e i lëkundur nisi të belbëzojë e të mos lidhte dot fjalët. Kërkoi ta çonin në banjë. Atje e mbyti shkuma dhe të vjellët"

Ndërsa gazeta "L'Unione Liberale" e datës 27 janar 1919, e njofton kësh-

tu vdekjen e Ismail Bej Vlorës: "Dje në mbrëmje, në orën 23:30, pushoi së jetuari në hotel "Brufani" miku i shquar i qytetit, Ismail Qemal bej Vlorë".

Hemorragjia cerebrale e goditi më 23 janar dhe si pasojë paralizimi. Për të përballuar sëmundjen nuk patën dobi as mjekimi më i kujdesshëm i mjekut që e kuroi, dr. Leone Pernosi dhe të konsulentëve, prof. Silvestrini dhe prof. Righetti dhe as prania e djemve.

VDEKJE NATYRALE APO E HELMUAN?!

Ende sot pas 100 vjetësh gjithçka ka mbetur një mister. Ismail Bej Vlorë vdiq për shkaqe natyrale apo e helmuan me kafën që piu në barin e hotelit para se të dilte në konferencë për shtyp?! Dyshimet shtohen edhe më shumë kur mëson se pas vdekjes, trupi i tij u mbajt për dy javë në Itali duke ia hequr të gjitha organet e brendshme, me qëllim balsamimin e trupit. Po përse duhet të balsamosej dhe t'i hiqeshin organet e brendshme, mungesa e të cilave pakëson në mënyrë të ndjeshme mundësinë e një autopsy për të gjetur shkaqet e vdekjes?! Gjithçka ndodhte kur në Vlorë dhimbja për vdekjen e Ismail Bej Vlorës ishte e madhe dhe bashkë me të edhe zemërat se ai mund të ishte helmuar nga italianët, të cilët e mbanin të pushtuar e të izoluar Vlorën nga pjesa tjetër e vendit. E mbanin të izoluar ashtu si mbanin të izoluar edhe Ismail Bej Vlorën, atje në Peruxhia, që ai të mos lëvizte për të shkuar në Paris.

DILEMAT E HELMIMIT!

Po nëse e helmuan, përse e donin të vdekur? Çfarë do të deklaronte Ismail Bej Vlorë në konferencën për shtyp? Çfarë dinte ai më shumë se të tjerët që duhet të vdiste? Kush ishin të interesuar për vdekjen e tij, italianët apo kundërshtarët e tij shqiptarë? Për çfarë ishte bërë pengesë vlonjati që kishte shpallur Pavarësinë e Shqipërisë? Përse iu vonua ndihma mjekësore dhe a pati një autopsy për të gjetur shkaqet zyrtare të vdekjes së tij? A janë të vërteta fjalët e djalit të pronarit të hotelit, në të cilin vdiq Ismail Qemal Bej Vlorë, se i kishte mbetur peng vdekja e plakut nga Shqipëria? Përse nuk është hetuar asnjëherë zyrtarisht edhe nga shteti

shqiptar në këto 100 vjet për vdekjen e kryeministrit të parë të Shqipërisë?

A ishin italianët të interesuar për vdekjen e Ismail Qemal Bej Vlorës?

Italianët ishin zyrtarisht pushtuesit e Vlorës. Qyteti i shpalljes së Pavarësisë ishte ndarë nga pjesa tjetër e vendit. Italianët e pretendonin Vlorën dhe në konferencën e Parisit, duke pasur deri dhe mbështetjen e Presidentit Amerikan, Eilson, për pretendimin e tyre. Italianët e kishin nxjerrë jashtë ligjit flamurin kombëtar në Vlorë. Kishin ndaluar festën kombëtare të flamurit dhe e kishin shpallur qytetin si provincë të Leçes. Po cila kishte qenë politika e Italisë në raport me Vlorën dhe krahinat e saj që nga hyrja në qytet, më 25 dhjetor 1914?

Italia në pushtimin e parë të vitit 1914, ndoqi një politikë ekstreme në të gjithë krahinat e Vlorës. Qëllimi ishte që popullsia vendase të pranonte pushtimin dhe t'u nënshtrohej rregullave të reja. Dorëzimi i armëve ishte kërkesa e parë e italianëve, për zbatimin e së cilës, italianët i përdorën të gjitha mënyrat, për të arritur deri në veprimin ekstrem. Kur panë se përveç zonës së Topalltisë, asnjë krahinë tjetër nuk i ishte përgjigjur thirrjes për dorëzimin e armëve, italianët vendosën bllokadën e drithit për popullsinë e këtyre zonave. Ata i ndaluan tregtarët e drithit që të sillnin drithë nga jashtë vendit. Në 6 prill të vitit 1916, popullsia e fshatrave të Vlorës, zbriti pothuajse e gjitha në qytetin e Vlorës, në kërkim të drithit për bukë.

Buka kishte kohë që u mungonte dhe uria kishte pllakosur vendin. Shumë njerëz filluan të vrisnin veten për shkak të urisë dhe pamundësisë për të siguruar bukën për familjet e tyre. Në fshatin Radhimë u helmuan shumë banorë, si shkak i përdorimit për ushqim i një bar të helmatisur. Të detyruar nga uria, krahina e Lopësit i dërgoi një ultimatum autoriteteve italiane, se nëse nuk u dërgohej ushqim, ata do të bashkoheshin me Greqinë ose me Musa Qazimin.

Në 24 prill 1916 erdhën 1200 dhe në 7 maj 1000 quintalë drithë, që përsëri ishin shumë pak në krahasim me kërkesat dhe urinë e madhe.

(Vijon në faqen 7)

SPECIALE

Mbërritja e trupit në Vlorë, censura italiane dhe fjalimet e delegatëve që shpallën pavarësinë. Ngritja e përmendores në 1932

Ceremonia e varrimit të Ismail Qemalit në Vlorë –12 shkurt 1919

Nga Ergys Alushi

NË TË VËRTETË, KËSHU NDODHI.

Nga Peruxha, trupi i pajetë i Ismail Qemalit, i cili fill pas vdekjes u balsamos, i shoqëruar nga djemtë e tij, u nis drejt Brindizit. Aty u vendos mbi luftanijen italiane “Alpino”, dhe arriti në Vlorë, në mbrëmjen e 10 shkurtit 1919. Atë natë arkivoli u vendos në komandën ushtarake italiane që ndodhej në Skelë. Aty qëndroi dy ditë. Ceremonia e varrimit u krye dy ditë më pas, ditën e mërkurë, më 12 shkurt 1919. Përcjellja e trupit nga Skela filloi në orën 10.00 paradite.

Aty qenë të grumbulluar gjithë popullsia e Vlorës, si edhe reparte ushtarake italiane me bandën e tyre muzikore. Kortezhin e prinin 12 kurora lulësh të dërguara nga populli i Vlorës, organet e qarkut e të krahinës së Vlorës, shkollat fillore të qytetit, qyteti i Fierit, shoqëria “Djelmoshat e Vlorës”. Një nga kurorat ishte e gazetës “Kuvendi”, në të cilën thuhej: “Ismail Qemal i Vlorës! Diplomati të vlerët”.

Edhe në këtë formulim shihej censura italiane, e cila lejonte që Ismail Qemali të nderohej jo si patriot, as si Ati i Pavarësisë së Shqipërisë, por si “diplomati i vlerët”. Kur kortezhin u nis nga Skela për në qytet, në krye qëndronin anëtarët e shoqërisë “Djelmoshat e Vlorës”, që mbanin kurorat. Pas kurorave vinin anëtarë të tjerë të “Shoqërisë djaloshe”. Pas tyre vinte banda ushtarake, e cila ekzekutonte melodinë e përmortshme “Jone” të kompozitorit italian Petrella.

Më tutje, vijonte një grup ushtarësh të regjimentit të 86-të, si dhe një repart italian mitraljerësh.

Pas tyre vinte karroca që mbante arkivolin e mbështjellë me Flamurin Kombëtar. Karrocën e tërhiqnin gjashtë kuaj të murrmë. Anës karrocës ecnin dy rreshta ushtarësh. Më pas vinin hoxhallarët. Pas tyre tre djemtë e Ismail Qemalit. Pastaj vinte gjenerali Settimio Piacentini, kundëradmirali Lubetti, autoritetet ushtarake e civile të krahinës, parësia e qytetit dhe e qarkut, qytetarët,

nxënësit e shkollave fillore të qytetit dhe një tufë ushtarësh kalorësie. Duke ecur me hap të ngadalshëm, kortezhin i përmortshëm arriti në qytet. Atë ditë, thotë korrespondenti i gazetës “Kuvendi”, Vlorë ishte në zi. Tregu ishte mbyllur. Në dyqane qenë ngjitur letra nekrologjike me rrip të zi anash, ku ishte shkruar: “Zi kombëtare për të madhin patriot Ismail Qemalin.” Duket se Flamurin Kombëtar të ndaluar nga komanda e pushtimit, qytetarët vlonjatë e zëvendësuan me nderimin nëpërmjet shpalljeve nekrologjike për Ismail Qemalin, “Patriotin e Madh”. Nëpër dyert dhe dritaret e shtëpive, shkruante korrespondenti, kishin dalë gra dhe vajza, për të nderuar “Plakun e Shqipërisë”, disa nga të cilat e kishin njohur në rini. Kur arriti në tregun e qytetit, kortezhin u ndal. Aty u mbajtën dy fjalime të përmortshme.

Në lidhje me këtë ceremoni, gjenerali S. Piacentini i raportonte Ministrisë së Jashtme të Romës po atë mbrëmje: “Se anija luftarake, Alpino, arriti në skelë mbrëmjen e ditës së hënë më 10 shkurt 1919; se më 12 shkurt ora 10.00 paradite u krye ceremonia e varrimit; se arkivoli me trupin e Ismail Qemalit u nis nga Skela në orën 10.00 paradite;



se sipas programit të parashikuar, mori pjesë batalioni i këmbësorisë së ushtrisë italiane me muzikë e flamuj. Ai nënvizonte se: Nuk pati asnjë Flamur Shqiptar, përveç atij që mbulonte arkivolin. U mbajtën dy fjalime nga paria shqiptare, të cilat, theksonte gjenerali italian: – “Më ishin bërë të njohura më parë se pjesëmarrja do të ishte e madhe. Rregulli qe maksimal. Nuk pati asnjë incident.”

Në lidhje me ceremoninë e varrimit të Ismail Qemalit, në ditarin e komandës italiane, ndër të tjera do të shkruhej:

“Mbushesh me hidhërim mbi varrimin e Ismail Qemalit, kur mendon se në qytetin e tij të lindjes, ku vetëm gjashtë vjet më parë patrioti i madh shpalli pavarësinë e Shqipërisë me entuziazmin e kombit dhe me pëlqimin e Italisë, tani ai nderohej jo nga ushtarë të vendit të tij, por nga trupat ushtarake italiane e që i vetmi Flamur Shqiptar i pranishëm ishte ai që mbulonte arkivolin e tij”.

Edhe pse aty mungonte ushtria shqiptare, në orën e varrimit të popullsia e qytetit dhe e rrethit qe rreshtuar anës rrugës nga skela në Kaninë nga do të kalonte arkivoli, ndërsa fshatarët mbushën dhe kodrat. Sipas dëshmitarëve, nga mizëria e fshatarëve kodrat dukeshin si koshere bletësh. Gjenerali italian nuk na thotë se cilët qenë dy personalitetet që mbajtën fjalimet e përmortshme në tregun e qytetit. Emrat e tyre i njofton korrespondenti i gazetës “Kuvendi”. Ata qenë Jani Minga dhe Qazim Kokoshi, dy delegatë që kishin marrë pjesë bashkë me Ismail Qemalin si përfaqësues të Vlorës në Kuvendin Historik që shpalli Pavarësinë Kombëtare, më 28 Nëntor 1912. Madje, ai na jep edhe fjalimet e tyre.

Jani Minga tha ndër të tjera:

“Popull i përzishëm! Shumë të brenjosur dhe shumë të vrenjtur të shoh sot. Vallë ç’gjëmë e tmerrshme të ka ngjarë e ç’mandatë të zezë ke dëgjuar? Pyes me

(Vijon në faqen 10)

Misteri shekullor i vdekjes së Ismail Bej Vlorës

(Vijon nga faqja 6)

Që nga pushtimi, në 25 dhjetor 1914, Malësia e Labërisë kishte mbetur ende në shumë fshatra jashtë ndikimit italian dhe për këtë qëllim “zyra politike” e Italisë në Vlorë kërkonte patjetër një shkak për të ndërhyrë forcërisht në këto territore. Përfaqësues të shërbimit sekret italian në Vlorë, së bashku me disa njerëz në Vlorë, mendonin gjetjen e një shkakut, sajimin e një ngjarjeje, e cila do të shkaktojte përçarje, frikë në popull, për ta pasur më të lehtë realizimin e qëllimeve që kishin.

“Plagosja e Ali Beqirit prej armiqvet personal u paralizua si e shkakëtuar prej njëi komploti Shqipëtar. Mbasi u organizua mirë komploti dhe ankmitë së plagosurit në gjyqin ushtarak se “u vrava prej komplotit Shqipëtar me që kurdohera kam punuar për kundra Shqipërisë në favor të Italisë” u vërtetua prej autoritetëve rrebel Prefekti Osmën Haxhiu, Major Ahmet Lepenica, Elams Bedini e shumë të tjerë filloi rreptësisht së vepruari gjyqi ushtarak dukë i burgosur ma se 50 idealistë kombëtarë. Me shumica ushtarësh rrethoheshin shtëpitë, lidhen njërës, prej krahinave dhe ashtu ca më shumë mbushen burgjet pitër më pitër me njërës”. (Sali Hallkokondi – Histori e Shqipërisë së Re, 1923).

Gjykata ushtarake pas hetimeve në lidhje me “komplotin” arriti deri sa të vendoste për varjen e disa banorëve vendas, që u akuzuan si pjesëmarrës në “komplot”, por që në fakt ishin të pafajshëm. Vendimet e kësaj gjykate shkakton një frikë të madhe në popullin e Vlorës, i cili qëndronte i tmerruar, ku secili në pritje se mos i dilte emri si pjesëmarrës në “komplot”, e për pasojë përfundonte në birucat e errëta apo në litar me varje. “Komploti” i Vlorës mbërriti deri në Parlamentin Italian, i cili u nda për sa i përkiste sjelljes që duhet të kishte politika italiane në Vlorë, ku njëra palë kërkonte që me faj apo pa faj të elimino-

heshin disa njerëz, dhe pala tjetër kërkonte një politikë më njerëzore të Italisë.

Një Komision i dërguar nga Parlamenti italian erdhi në Vlorë për të hetuar në mënyrë të drejtë për ngjarjen e ndodhur dhe pas hetimeve liroi nga burgu shumicën e të arrestuarve e të dënuarve si “komplotistë”.

“Zyra politike” e Italisë në Vlorë, jo vetëm që nuk kishte arritur të çrrënjoste idetë kombëtare, por nxiti edhe më shumë urrejtjen në popull, ndërkohë që dhjetëra banorë të krahinave të Vlorës kishin emigruar në Itali nga frika e ndëshkimit. Pati edhe vlonjatë, të cilët fituan simpatinë e zyrës politike italiane në Vlorë, duke mbështetur politikën e saj në dëm të interesave shqiptare, dhe për këtë u shpërblyen me vende pune të mira dhe fituan duke u marrë me tregti. Krahmasave të tilla represive ushtarake, italianët të mbështetur dhe nga vlonjatë antikombëtarë, ndërmorën dhe një propagandë të madhe për kulturën italiane, duke hapur në shumë fshatra shkolla për të mësuar gjuhën italiane. Me fuqizimin e saj në Vlorë dhe me frikën e madhe që kishte shkakëtuar në popullatë, më 17 maj të vitit 1916, italianët nuk e ngritën më flamurin kombëtar të Shqipërisë, në Prefekturë. Pas disa ditëve e vendosën përsëri atë, për ta hequr përsëri atë më 20 gusht.

Më 15 shtator 1916, në zyrat e Qeverisë së Vlorës varet vetëm flamuri italian, ndërkohë që u shpall Vlorë si e lidhur me Leçen, duke e njohur si një provincë të saj. Italianët ndaluan të gjitha ceremonitë festive kombëtare. Por edhe në mes të shtypjes së madhe dhe ndalimit të flamurit e festave kombëtare, në 28 Nëntor 1916, me iniciativën e Avni Rustemit e Bajram Hallkos, një grup vlonjatësh dolën në shesh për të kujtuar përvjetorin e shpalljes së Pavarësisë.

Karabinierët e shumtë italianë ishin në gatishmëri për të ndërhyrë, por frika se mos ndërhyrja shkaktojte gjakderdhje dhe e turbullonte më shumë politikën italiane në Vlorë, e shmangu përplasjen.

STUDIMI

PJETËR BUDI, shkrimtar i mirënjohur i letërsisë së vjetër shqiptare, klerik i lartë

Injac Zamputi mbi të vërtetën e

Nga Xhemal MEÇI*

PJETËR BUDI, Gur i Bardhë, Mat, 1566 -25 dhjetor 1622), qe shkrimtar i mirënjohur i letërsisë së vjetër shqiptare, klerik i lartë katolik, veprimtar i shquar i Lëvizjes Çlirimtare kundër pushtuesve osmanë. P. Budi shërbeu disa vjet meshtar në Kosovë e Maqedoni. Më pas u caktua vikar i përgjishëm i kishës katolike në viset ku kishte shërbyer. Më 1516 shkon në Romë për botimin e librave të tia dhe organizimin e kryengritjes antiosmane. Më 1618 në Romë botohet Doktrina e Krishtenë në afro 3000 faqe (ribotuar më 1636, 1664, 1868). Më 1621 boton në Romë -Pasqyra e të Rrëfyemit. Doktrina e Krishtenë dhe Pasqyra e të Rrëfyemit nuk janë thjeshtë përkthime, por përshtatje e me shtojca me vjersha e mesazhe, porosi e këshilla të shumta drejuar katolikëve shqiptarë, ku ankohet edhe për mungesën e shkollave (Fjalori E. SH. , Tiranë, 2000, f.316-317).

Gjatë shekullit tonë veprat e Budit u bënë një burim i mirë për njohjen e gjuhës shqipe, të historisë së vendit tonë dhe të etnografisë shqiptare. (Prof Dr. J. Kastrati, -Historia e Albanologjisë, Tiranë, 2000, f.77-78).

(INJAC ZAMPUTI 1910 - 1998), PËRKTHYES DHE HISTORIAN I SHQUAR I MESJETËS. (F. E. SH. Tiranë, 2000, f. 2975.) I ndjeri Injac ZAMPUTI ishte burrë fisnik, modest dhe dashamirës, me të cilin jam takuar disa herë për përkthime dhe daktilografime për nevojat e Muzeut Historik të Pukës. Më priste edhe në shtëpi me dashamirësi e bujari. Ishte 6 dhjetor 1971, kur po bisedonim në shtëpinë e tij për Komanin.

Si u përqendrua pak, më pyeti nëse dija gjë për "Vaun e Priftit". Është diku në Koman-tha. -Aty është mbytur i shquari Pjetër Budi. Po jua jap një material, "shënime mbi vdekjen tragjike të Pjetër Budit". I kam mbledhë me kohë, por botimin do t'jua besoj ju. Kur ta shihni kohën e përshtatshme e botoni, por me kusht që të mos shfrytëzohet kundër Kishës e kundër Klerit Katolikë shqiptar. Të mos ia japim kuj atë kënaqësi për ta përdorë kundër Kishës e Klerit tonë katolikë." Kuptohet, se me -"Të mos ia japim kuj knaqësinë"- e kishte fjalën për regjimin komunist, që kishte dënuar aq ashpër klerin, sidomos klerin katolikë që më 1944 e në vazhdim.

Unë kam mbajtur lidhje me takime e letra. Në letrën e ti përgjigje, dt.6 korrik 1985, më shkruante shumë miqësisht: -"E kam marrë letrën tuaj të 4 korrikut (1985)... Gëzohem shumë se punoni dhe bëni një punë të frytshme. Unë përherë kam parë te ju njeriun punëtor dhe të përgatitur për të kryer studime të nevojshme për vendin e popullin tonë." Në kuadrin e 450-vjetorit të lindjes mendova se duhej botuar ky material i vyer i të ndjerit Injac Zamputi. ato "shënime" ishin një amanet, që m'u besua mua dhe m'u lanë nga një studiues aq i shquar e njerëzor, siç ishte i ndjeri I. ZAMPUTI, aq më tepër duke më



besuar edhe sigurinë e vet përballë regjimit të diktaturës. Ky ishte një nder që më bëhej mua nga një personalitet i historisë sonë kombëtare. Rasti e solli tani ta kryej këtë porosi në këtë përvjetor të vdekjes, të pavdekshmit Pjetër BUDI.

"Shënimet" fillojnë drejtpërdrejt kështu: - "Farlati", (III.Soc.VII/294), kur flet për vdekjen e Pjetër Budit, ... shënonte... "Por s'qëndroi në detyrë as një vjet të plotë, sepse, tue kalue lumin e Drinit qe përpimë..."

Mario Rok (Mario Roques) citon një burim tjetër për vdekjen e Pjetër Budit: një pjesë nga letra e Gjon Kolesit drejtue Kongregacionit të Propagandës më... 20 janar 1623, në të cilin thuhet: "I peshkëvi mbasi kështu i pëlqei nanës së Zotit, u mbytur n'uj sa po kalonte një lum, dhe të gjithë krishterimit t'atye anëve i ka ramë shumë keq, dhe me qenë se kanë mbetur pa bari...propozohet të emënohet Vikari i Përgjithshëm i Zadrime, Gjergj Bardhi. (M.Raques: Recherches sur les ancains, textes albanais etc. Paris, 1932, fq. 30-31; shënimi 6).

(fq.68)... data e vdekjes merr saktësim ma të madh në 25 dhjetor 1622. Ja fjalët e letrës në të cilën lajmon: ..."për çështjen e mjerueshme që i ngjajti përpara festave të Krishtlindjeve, Imzot Bu-

dit, Ipeshkëvi i Sapës në Arbëni, i cili, kur po donte me kalue lumin e Drinit për të pajtue një farë kishe asht mbytur në lumin e thanun pa e pasë pamë ma kush trupin e tij...". (B.Orsini, Lezhë, mars, 1623, fq. 222). "...nevojë e madhe duhet ta kenë shtërngue P.BUDI me marrë rrugën nëpër male n'atë muez që nuk paraqet kondita të mira. Ne mendojmë pikërisht për këtë arsye se udhëtimi i tij ka qenë me qëllime që nuk ishin krejtësisht të administratës kishtare. Pjetër Budi ishte përgatitë të rrinte në Shqipni për qëllime të caktueme në

lidhje me organizimin e luftës për çlirim. Ja çka shkruante ai, -vazhdon të mendoj I. Zamputi,- në letrën drejtue Gocadines pak ditë para se të nisej me ardhë në Shqipni (15 shtator 1621): "Popujt e sipërthanun presin nga unë personalisht njoftim për të dëjtë ç' vendim ka marrë Shenjtëria e Tij Papa për këtë dëshirë të tyne [d.m.th. t'ia nisin luftës antiosmane -I.Z.], dhe më nxisin që unë të kthehem me një përfundim të mirë, dhe mue tashti do të më duhet të shkoj t'i ngushëlloj... sepse ky lajm i mirë [d.m.th. se çështja e luftës asht tuj u marrë seriozisht -I. Z.] do të jetë për gëzim të madh t'atye popujve. Dhe, në mënyrë që ky shëstim i shenjtë të mos zbulohet prej anmiqve, do t'u sjell kë-

tyne popujve ndonjë ndjesë të plotë ... me ndonjë bekim për ato vende... dhe do të shpërndaj librat e mij... kështu shkruemja ime të mos sjellë dyshim..."

"Budi, -thekson Injac Zamputi, -pra e dinte mirë se vepra e vet ndiqej nga armiqët dhe mendohej ta fshihte me shërbimet fetare, që do të kryente si ipeshkëv nëpër popullsitë tona malore që ishin në kryengritje.

...nuk përjashtohet mundësia që Drinin Budi ta ketë kalue kund në ndonjë va, në ndonjë vend ma pak të rrezikshëm. Në këtë rast do të mendonim se të gjithë udhëtarët kanë qenë së bashku dhe atëherë del e vështirë të mendohet si asht mbytur vetëm personazhi kryesor i atij grupi, i cili -sikurse ishte e natyrshme -duhej të kishte vendin dhe rojën ma të sigurtë. Përsa i takon vau, del se vau më i përshtatshëm ishte në Koman. (Unë jam konsultue me komanës, ndër ta edhe me Ndoc Doçaj, i cili ende i ruan lidhjet me Koman, ku shkon nga Puka dhe punon tokat e kujdeset për pemët e pronës së tij bujqësore. Ai ka mendimin se në mes "Proit Grad" (apo Grazhdës) dhe Kishës Shën Markut, përfund Livadheve të Kishës ka qenë një va, -"Vau i Priftit". po ky va nuk ka qenë i njohur për shumë kohë, se përdorej kryesisht verës. Ndoc Selimi, autor i librit "Kultura Komanit..." (Shkodër, Volaj, 2013) Më ka treguar se "Në të rënë të Gogshit, përballë shtëpive të para ka qenë një gur me emrin "Guri i Lundrës", ku ka qenë një va nëpër të cilin dilej në Gushtë. Ndofta ky ka qenë "Vau i Priftit". Por më siguri Nd. SELIMI ka për Vaun e Karmës afër shtëpisë së Llesh Dedës, në të dalë prej Komani për Karmë. "Aty -thot Ndoci- më ka kaluar më 1960 në atë va Pjetër DEDA.

Si përfundim, në njërin prej këtyre vanash në këtë hapësirë të bregut të Drinit prej afro 10 km, por ka mundësi të jetë "Vau Priftit", në fund të "Arës Priftit", i cili ishte fare afër kishës SHMAR-KUT, ku ka pushuar para se të nisej për Mazrek se i dukej më afër aty për të kaluar Drinin për Mazrek, ku është mbytur i ndjerit P. Budi, më 25 dhjetor 1622.

Armiq (fq.73) të deklaruem kundër Pjetër Budit kanë qenë edhe venedikasit, sepse ky njeri kishte "guxue" të hynte në çështje të çlirimit të vendit tue kërkuë marrëveshje me spanjollët e tue bashkëpunue me persona që Republika (e Venedikut-Xh. M.), i ndiqte për vdekje, si asht rasti i kalorësit Bertuçi, i cili asht personazhi kryesor në letrën-projekt drejtue Gocadinos.

Vetë fakti i gjetjes së kësaj letre në arkivin e Venedikut, na jep të drejtë të mendojmë se agentët e Republikës (VENEDIKUT) i ishin lëshue mbi shpinë këtij njeriu. Ka edhe një mundësi tjetër, d.m.th. që kjo letër e arkivit të Venedikut të mos jetë origjinali, por ndonjë kopje e tij, dërgue në Venedik nga ndonjë njeri, që aty, në Romë hetonte për llogari të Republikës, për veprimet e Pjetër Budit.

Por, armiq të betuem kishte edhe klerikët e huej, sidomos prelatët, kundër

(Vijon në faqen 9)

STUDIMI

katolik, veprimtar i shquar i Lëvizjes Çlirimtare kundër pushtuesve osmanë

mbytjes tragjike të PJETËR BUDIT

të cilëve ai kishte shkaktue mbledhjen kishtare që vendosi të mos pranoheshin ipeshkv të huej.

Por Pjetër Budi, kur erdhi dhe u vue në krye të selisë ipeshkvnore të Sapës, i krijoi vetes edhe një kundërshtar tjetër të fortë: vikarin e deriatëhershëm të diocezit të Zadrimës, Gjergj Bardhin.

Gjergji apo Gjeci ishte djali i vëllait të ish-ipeshkvit të Sapës Nikollë Bardhit. Ky i fundit asht i njohur në historinë e lëvizjeve shqiptare të sh. XVI dhe fillimit të shek. XVII. Ka të ngjamë se fill pas ikjes ose pas vdekjes së ungjit, Gjergji erdhi në zyrën e vikarit të Sapës mbase kish qenë ma përpara famullitar në Rodon (në dioçez Albaneus (?)) dhe vikar i ipeshkvit të Stefanisë (Nikollë Mekajshit). Vikariarin e Sapës e mbajti 16 vjet(Farlati, VII, 284). Ipeshkvi i Sapës, përveç administratës kishtare, kishte edhe kryesinë e këshillit të Zadrimës për çështjet civile.

Nikollë Bardhi, ipeshkvi i Sapës, qe një ndër organizuesit e kuvendit të madh të Dukagjinit më 1601-1602 bashkë me Nikollë Mekajshin etj. Kuvendi e ngarkoi Nikollë Bardhin të shkonte në Venedik bashkë me kapitanin Pal Dukagjinin për t’ia paraqitë senatit venedikas nevojat e lëvizjes që donte me shpërthye në luftë të armatosun. Dihet se Venediku i pengoi këto përpjekje dhe ma në fund Nikollë Bardhi, pasi mori 400 dukatë prej Republikës, shkoi në Romë dhe u muer me punë të tjera.”

(Shih artikullin: I.Z. “Projektet shqiptare për çlirimin e vendit etj.” në Buletinin për Shkencat Shoqërore, 1956, nr. 4, fq. 122-123).

“Zadrima, -na tregon Frang Bardhi, në relacionin e vet (Bul. për Sh. Sh. këshilli, në krye të të cilit ishte ipeshkvi i Sapës. Pra, ai ishte në krye të këshillit të Zadrimës fushore. Ai ishte edhe ipeshkvi i maleve të Dukagjinit, në të cilat përfshiheshin Puka, Iballja dhe Spasi. Gjergj Bardhi sa qe vikar i Zadrimës, duhet të ketë ushtruar të gjitha funksionet e një ipeshkvi.


Kur më 1614, u zhvillue në Kuç kuvendi që bashkoi delegatë nga të gjitha vendet kryengritëse, na duket se hetojnë edhe figurën e Gjergj Bardhit, që përfaqëson Dukagjinin (Mirditën, apo Pukën, ose të dyja së basku). Dhe ai jo vetëm asht një delegat i zakonshëm, por përfshihet në gjashtë të parët, d.m.th. n’ata që kishin autoritet të theërrasin delegatët në kuvend.”

(Shih artikullin: I.Zamputi, “Bashkimi i maleve shqiptare etj”, në Buletinin e Univ., Seria Shk. Sh. vj. 1957, nr.1)

Në transkriptimin që ka bamë L.M. Ugolini (Pagine di Storia Veneta, fq. 26 e tutje), n’emnat e deputetëve të mbledhun të 15 korrikut 1614, i katërti asht Gieli Bardi da Mirdita. Vështirë do ta kishim të hetonim në këtë transkriptim emnin e Gjerc Bardhit, mos të ishte për fat ma tutje edhe lista tjetër e 44 zotnive besëlidhun.

Në këtë listë, këso radhe, i pesti emën lexohet: Gierdi Bardi da Mirdita. Nuk ka dyshim prandaj se bëhet fjalë për Gjerc Bardhin.

“Dhe na mendojmë,- nënvizon faktin I. Zamputi, “-se asht tamam Gjerc Bard-



hi ynë, me qenë se për Mirditë aso kohe duhet kuptue i gjithë vendi malor i Dukagjinit dhe mbi këtë vend nuk kishte aso kohe tjetër autoritet vendas ma të madh se vikarin e Sapës.

Bardhi, sa kohë që qe vikar në Zadrimë, e ushtroi mirë edhe detyrën e kryesisë së këshillit dhe ishte tregue shumë i aftë qyshë se me një ndërhyrje të tij, në Stamboll ia kish dalë të hiqej nga kamba edhe Sanxhakbeu (i Shkodrës -Xh. M.), që i kishte qitë ngatërresa Zadrimës. (më 1610).

Një njeri si Gjergj Bardhi, i cili pas vjetit 1623 ka për të qenë administrator kishtar i sprovuem dhe rigoroz, dhe ka për t’u tregue mprojtës fanatik i të drejtave të veta, nuk asht çudi që Pjetër Budin, kur erdhi në zyrën e ipeshkvisë së Sapës, ta ketë shikue si armikun që po vinte t’i hiqte nga dora të drejtat e fitueme. Këto të drejta mbi Zadrimë, Gjergj Bardhi i mbështet kryesisht mbi të drejtat e derës së Bardhejve, që ishte e fortë dhe që i kishte dhanë vendit të vet dy ipeshkvij... Këtë të drejtë Gjeci ka për të vazhduë ta kërkojë për vete dhe për nipin e vet, Frang Bardhin dhe gjithë Zadrimën ka për të vazhduë ta mbajë në dorë të vet edhe pas vdekjes së nipit, kur prap ai, tue qenë arqipeshkev i Tivarit, ka për ta lëshue atë seli e ka për të kthye prapë në Sapë. (Farlati,VII, 288).

Kur, pra, pas vdekjes së Budit, Gjergj Bardhi vrapoi në Romë për ta sigurue për vete selinë e Sapës, u përcuell me tri propozime të favorshme: nga ipeshkvi i Arbënit, nga ai i Lezhës dhe ai i Shkodrës...

Kur i paraqitej Papës propozimi për emërimin e një prelati, i paraqitej edhe një fletë informative mbi personin e shenuem. Në këtë fletë renditeshin pikat në favor dhe në disfavor të kandidatit. Këtë fletë informative të përpilueme për Gjergj Bardhin, e ka plotësue ai, që kishte qenë ngarkue ta marrë në provim për të gjykue mbi aftësitë e tija... Ka shumë mundësi që autori i kësaj flete informative të jetë kardinali Pjeter Vale-

rio, që Farlati thotë se qe ai që e emnoi Gjergjin (Farlati, VII, 284). Në këtë fletë, pas anëve pozitive që ka Gjergj Bardhi, shënohen vetëm dy pika negative për emnin e tij: e para, se nuk ka instrukcion të mjaftueshëm, por mendohet se, tue pasë aty pranë në Lezhë Benedik Orsinin, mund të këshillohet me te. Pika e dytë e që na intereson, asht kjo: “Dyshohet se mos asht bashkëveprues në vdekjen e dy ipeshkvijve të kaluem, sepse m’u referue nga kapitani Ranier, se abati Pal, i ardhun [në Romë-I.Z.] së bashku me Bardhin e thanun, ka thanë në prani të disave, që po nuk e banë ipeshkëv F, Bardhin, por ndokënd tjetër, do ta nisim si kanë shkue dy të kaluemt. [Por] mund të provohet se asht një shpifje, sepse kanë ardhë [po në Romë-I.Z.] disa fretër me letra të N/Mbretit të Napolit drejtue kardinalit Ludovizi dhe njeni prej tyne pretendonte Ipeshkvinë, dhe kapitani Ranier, kur më lajmëroi për thanien e abatit Pal, më paraqiti si të mirë njërin nga fretnit e thanun... (IR CG, vl. 262, fl.467).

...Asgja nuk na pengon të mendojmë se abati Pal (Pal d.m.th. Abati i shën Palit Kabash, Nikollë Leka, shënimi i Xh. M.) me të vërtetë t’i ketë thanë ato fjalë në një moment kur ndoshta çështja e Gjergj Bardhit paraqitej e humbur.”

Dhe, i ndjeri I. Zamputi arrin në konkluzionin: “në qoftë se fjalët e abatit kanë vërtetësi, na mendojmë se pas tyne fshihen edhe venedikasin. Këta nuk e duronin që kurrsesi influencën spanjolle në Ballkan dhe në çdo kohë kanë pengue dhe kanë luftue përpjekjet e popullsisve tona për çlirim, kur i drejttoheshin Papës, Spanjës ose princave të tjerë. Kjo asht arsyeja që na ban të anojmë me mendue, sikurse thamë, se vdekjen e Pjetër Budit e kanë dashtë vetë venedikasin dhe kanë përkrahë e ushqye sedrën, dyshimet dhe konfliktet e zadrimorëve, të klerit dhe të turqve, ose të gjithëve së bashku.

Bëhej përpjekje e madhe për të sigurue selinë e Sapës, n’ato kohë, kur

projektet për çlirimin e Shqipnisë e të Ballkanit mbështeteshin kryesisht nga popullsitë tona malore. Dhe Sapa, sikurse dihet, kishte në juridiksionin e vet edhe Dukagjinin. N/Mbreti i Napolit donte n’atë seli një njeri që të vazhdonte veprën politike të Pjetër Budit, të njohur për përpjekjet e tij antiturke dhe antivenedikase. Gjergj Bardhi nuk u pëlqente spanjollëve, sepse ishte i nipi i atij Nikollë Bardhit që kishte veprue haptas sipas udhëzimeve të Republikës së Venedikut. Nga vetë fakti se spanjollët nuk e duen Gjergj Bardhin n’atë seli, provohet mjaft qartë, se ky ndër 16 vjetët që qëndroi aty si vikar, nuk u ka shkue për qejf atyne dhe mundet që ka vazhduë udhëzimet e ungjit dhe ka qenë në marrëdhënie të mira me venedikasin. Kjo mund të hetohet edhe në frytin që nxori Gjergj Bardhi në Stamboll kur shkoi për t’u ankue kundër sanxhakbeut.Venedikasin kishin influencë në Stamboll sa ta mbështesnin pranë vezirëve të Sulltanit.

Në përpjekjet që bënin kundër synimeve spanjolle, venedikasin bashkëpunonin me turqit dhe ua zbulonin atyne orvatjet e shqiptarëve e të huejve që donin me organizue luftën për çlirim... S’ka dyshim se venedikasin kishin mundësi të shtinin në punë ma së miri edhe veprën e një pjese të klerit të huej për ta ushqye konfliktin që ngjallej sidomos kur ishte rast-si asht fakti i mbledhjes së bame nga kleri vendas në kryesinë e Budit...

Venedikasin kishin edhe aftësi të madhe të shfrytëzonin kontradiktat që kanë ekzistue edhe mbrenda vetë klerit shqiptar: Kështu pra janë ndjekur nga partia e venedikasve ata që mvaren nga Papa e nga Mbreti katolik [i Spanjës-I.Z.] me anën e disa njerëzve, të cilët, tue i shërbye me dy faqe këtij dhe atij princi, nuk synojnë tjetër veçse të jenë shpërblye n’ato sende për të cilat meritojnë dënim...” (Nga një relacion i kohës: Cordignano, vep.th.fq.7/231).

...Pas këtyre të dhënave...pohojmë se Pjetër Budi, për veprimtarinë e tij të shumëfishtë kombëtare-shqiptare, vdiq pa mbushë vjetin në zyrën ipeshkvnore, sepse armiqtë e gjetën rastin me krye deliktin. Dhe e maskuen tuj fajosë vetëm rrjedhën e Drinit.”

Perfundimisht, studiuesi i shquar Injac Zamputi është i mendimit se mbytjen e Pjeter Budit e kishte kryer Nikollë Leka, ish-Abati i Shën Palit të Kabashit (abati Pal), një aventurier, që kishte përfunduar me një çetë rebelësh. Fr. Bardhi thekson faktin se –“Dom Nikollë Leka ka çue krye ndaj rregullës kishtare dhe është bamë ushtarë i Shën Markut (Venedikut), dhe ka mbledhë ushtarë dhe anije të armtosuna si të qenkësh një shekullar” (nga shënimi i I. Zamputit, f.289, Relazione II, Tiranë, 1965).

Sigurisht, kontradiktat mes klerit katolik kanë qenë të natyrshme sepse: shkakttoheshin kryesisht nga mosmarrëveshjet me klerin e huaj për zbatimin e shërbimeve fetare në gjuhën shqipe, si dhe përçarjet mes klerit , të nxitura nga ndërhyrjet e shteteve të huaja për interesat e tyre politike.


PROFIL

*Studiues, “Mjeshtër i Madh”, Muzeu Historik Pukë

PARTIZANI ADEM JAUPI – KAPITENI TRIM QË ÇAU DET EDHE OQEANET

SHPENDI TOPOLLAJ

Postulati se njeriu nuk vdes kur mbulohet me dhe, por kur harrohet, vërtetohet plotësisht në rastin e “djaloshit të detrave”, skënderbegasit nga të parët, kapitenit të anijes, Adem Jaupi i cili ndërroi jetë më 13 Qershor të vitit 2005, në moshën 76 vjeçare dhe nuk ka njeri të mos e ndiejë të gjallë edhe sot e kësaj dite, pasi virtytet e tij të rralla e bënë të pavdekshëm. I lindur më 22 Mars të vitit 1922 në Korçë, ai qe i biri i luftëtarit të 1920 – ë, Emin Jaupit dhe i dy vëllezërve partizanë, Kekos dhe Iljazit. Edhe vetë, pasi u përfshi në rininë antifashiste qysh në vitin 1942, nga 12 Shtatori i vitit 1943 u bashkua me batalionin Partizan “Tomorri” e më pas në Brigadën e XX - Sulmuese. Në librin “Luftëtarët që bënë epokë nuk duhen harruar”, për Kekon shkruhet: “Luftëtar trim që sfidoi plagët e luftës”, kurse për vetë Ademin thuhet: “Partizan trim e marinari i talentuar”. Ademi, porsa u çlirua Shqipëria, ende me armë në dorë, u rreshtua në radhët e shkollës ushtarake “Skënderbej” së bashku me shokë të tjerë, kryesisht të zbritur nga malet ku kishin luftuar për liri. Ata, me entuziazmin dhe vlerat e tyre të mëdha, me idealet në të cilat besonin, hodhën themelet dhe krijuan traditat e lavdishme për të gjithë ata që në vazhdimësi do studionin në këtë shkollë të lavdishme. Në vitin 1947 së bashku me një grup skënderbegasish, dërgohet në qytetin Divulje të Jugosllavisë, ku do të studionin për oficerë të Flotës tonë Luftarako - Detare e cila ishte në krijim e sipër dhe kishte nevojë të ngutshme për kuadro. Ademi, me kërkesa të mëdha ndaj vetes, u shqua për dëshirë për të mësuar dhe për t’u bërë i vlefshëm për vendin e vet, por nuk vonoi shumë dhe marrëdhëniet midis dy vendeve tona u prishën, kështu që studentët shqiptarë u kthyen para kohe në atdhe. Por shumë shpejt, qeveria jonë mori masa që studimet e nisura t’i përfundonin në ish Bashkimin Sovjetik. Ndaj në vitin 1949, Ademi shkoi në Akademinë e Lartë Ushtarake për Navigacion në Republikën e Azerbajxhanit dhe me ta përfunduar në Shtatorin e vitit 1952 me rezultate shumë të mira, pasi kryen detyra të ndryshme në Flotë, emërohet në aparatin e Ministrisë së Mbrojtjes, ku shërbeu në periudhën 1958 - 61. Këtu shkëlqen talenti prej ushtaraku të kulturuar i oficerit të marinës Adem Jaupi i cili zotëronte disa gjuhë të huaja si serbokroatisht, italisht, anglisht dhe natyrshëm rusisht, ku kjo e fundit i jepte mundësinë e zhvillimit me kuadrot e marinës të veprimtarive për ngritjen teoriko - praktike. Duhet shtuar se ai njihnte mjaft mirë edhe gjuhën Esperanto. Flota jonë ushtarake po fuqizohej dhe detyrat ishin në rritje, kështu që ai e kuptonte se stadi që po kalonte ushtria kërkonte një nivel të lartë të kuadrove. S’duhet harruar se vetë Ademi ishte një lexues i shkëlqyer, si shumica e atyre djemve që kishin kaluar nga bangat e shkollës “Skënderbej”. Biblioteka e tij ishte jashtëzakonisht e pasur. Aty do të gjeje autorë vendas me emër



si Fishta, Noli, Jakova, Kadare, Agolli etj. dhe të huaj si Dostojevski, Gorki, Shollohovi, Gogoli, Remarku, Dumasi, Drajzeri etj. etj. Atë e tërhiqte pa masë edhe muzika e sidomos ajo korçare dhe shkodrane, prej nga kishte dhe të shoqen, motrën e të madhit futbollist të viteve 1950 - 65, Dul Duma.

Pasi vazhduan prishjet edhe me ish Bashkimin Sovjetik, në vitin 1961, duke parë se edhe nevojat e Flotës Tregtare për kuadro drejtuese ishin të mëdha, Ademi kalon në marinën tregtare, duke jetuar familjarisht në Durrës. Por në të vërtetë, ai më gjatë jetonte detrave, pasi ku nuk ka shërbyer më së shumti si kapiten vaporit që nga “Vlora”, “Arbëria”, “Vampo”, “Liria”, “Partizani”, “Teuta”, “Skënderbeu”, “Mati”, “Durrësi”, “Tirana” etj.

Kishte katër fëmijë, por ai ishte i ndërgjegjshëm për sakrificat dhe privacionet e një lundërtari të linjave të largëta, ndaj asnjëherë nuk u ankua. Ndaj dhe në qytetin ku banonte, atë e shihje përherë të qetë dhe të qeshur me të gjithë. Njeri i përzemërt, ai mbeti dhe i thjeshtë dhe i shoqërueshëm me këdo dhe sidomos me kolegët e tij si Zeqo Feçani, Qemal Hate, Zaçe Zhupa, Ali Bardheti, Rushan Tusha, dhe sidomos me profesorin e detarisë Shaqir Kafexhiun. Duhet të jesh njeri me durim dhe vullnet të hekurt që të përballosh rrugët e pafund të disa kontinenteve për dekada të tëra. I tillë ishte ky burrë me karakter që i ra kryq e tërthor porteve të Evropës, Afrikës dhe Azisë, deri në Kinë, vetëm e vetëm që të realizonte detyrat e ngarkuara në interes të popullit të tij. Ademi, me vaporin e tij që i pari që kur u mbyll kanali i Suezit, i ra rrotull Afrkës, për të shkuar në R.P. të Kinës. Por edhe pse përherë gjente forca të mos epjë para vështirësive, dhe me zgjuarsitë të rrallë dhe gjakftohësi, dinte të merrte vendimet e duhura, ndodhi që në kushte shumë të vështira të motit, anija “Mati” që ai drejtonte, u mbyt në portin e Kostancës në Rumani. Ishte viti 1976 dhe ai pas përpjekjeve mbinjerëzore, ashtu siç ia kërkonte nderi i kapitenit, u largua nga anija vetëm pasi u sigurua se kishte shpëtuar të gjithë ekuipazhin. Mënyra sesi ai luftoi dhe qëndroi para kësaj fatkeqsie ishte një shembull mjaft domethënës për të treguar se çfarë djemsh kishte farkëtuar fidanishtja e ushtrisë, shkolla ushtrake “Skënderbej”. Duhet thënë se vlerat e këtij kuadri i njohnin edhe të huajt, të cilët i kishin dhënë lejen e rrallë që të ishte i lirë për të dalë e vizituar të gjithë

qytetet e Porteve ku anija e tij ankorohej. Pas një pune të gjatë në Flotën Ushtarake dhe atë Tregtare, Adem Jaupi doli në pension në vitin 1984. Por edhe tani, ai nuk ndahej nga shokët e miqtë e dikurshëm dhe aktivizohet rregullisht në Organizatën e Veteranëve të Luftës Nacional - Çlirimtare dhe shoqatën detare “Adriani”. Për luftën dhe punën e tij, Presidiumi i Kuvendit Popullor i ka akorduar disa urdhra e medalje. Kur ai mbylli sytë, lajmi u dha nga televizioni i Durrësit “Teuta”, gazeta “Kushtrim Brezash” dhe revista “Esperanto” që botohet në Hollandë. Ja pse në qytetin e Durrësit, ku ai prehet, gjithkush kur flet për të e kujton ende si të gjallë.



Ceremonia e varrimit të Ismail Qemalit në Vlorë –12 shkurt 1919

(Vijon nga faqja 7)

pikëllim shpirti. Pyes me zemër të dridhur. Po mjerisht kudo ku rrotulloj sytë, kudo ku mbaj veshët një zë përgjigjet për çdo anë, nga çdo fytyrë e venitur dhe e shkëmbyer e juaja del një zë i helmueshëm dhe i shëmtuar dëgohet “Vdiq Ismail Qemali! Vdiq Plaku i Vlorës! Plaku i Shqipërisë!” Heu! Thuaj më mirë o i mjerë popull vdiq burri më i madh i Shqipërisë, luftëtar më i fortë i mendjes, i ndjenjave dhe i mendimeve kombëtare, vdiq mburoja më e fortë dhe më e madhe e kombit, vdiq politikani ynë më i madh dhe diplomati ynë më i dëgjueshëm në fushë të politikës e të diplomacisë Evropiane.”

Nga fjala që mbajti Qazim Kokoshi përpara trupit të Ismail Qemalit, shkëputim këto rreshta:

“Helmi dhe dëshpërimi që goditi gjithë bashkatdhetarët nga kjo gjëmë ishin aq të mëdha sa na pëlqente në ditën e shpalljes së Pavarësisë Kombëtare, që të mos ta besonim, donim të shpresonim që lajmi të mos ishte i vërtetë, dhe Ismail Qemali të mos kishte vdekur që kësaj ai me gjalljen e tij të mund të kryente plotësisht qëllimin e shenjtë që kishte filluar që në kohën e djalërisë, dhe për të cilin kishte marrë në sy pësimet e mërgimin me shumë rreziqe, me shumë vuajtje e të këqija. Por, mjerisht, këto shpresa nuk u vërtetuan pse thonjtë e tmerruar të vdekjes e rrëmbyen Ismail Qemalin. Një e tillë humbje, sidomos në një kohë kur atdheu i tij priste shërbimin më të madh, priste nga fuqia e mendjes së tij kurorëzimin e të drejtave dhe të dëshirave Kombëtare, një e tillë mynxyrë, në një kohë të tillë, kur fati i të gjorit komb Shqiptar është duke u shqyer përjetë, na duket se e shton helmin e dëshpërimit tonë më shumë se çdo herë.”

Qazim Kokoshi e mbylli fjalën e tij kështu:

“Ismail Bej! Të përunjemi dhe të sigurojmë që Shqipëria, ndonëse e vogël, e varfër dhe e paditur, të çmon dhe kujtimin tënd do ta ketë si rrënjë të idealit të saj.”

Pas fjalimit të tyre, ushtria italiane i bëri nderimin e fundit Ismail Qemalit, duke ekzekutuar himnin mbretëror, sigurisht të Italisë. Që këtë reparti i kalorësisë italiane së bashku me të parët e fesë, parësinë e qytetit e një masë e madhe qytetarësh vlonjatë e shoqëruan arkivolin drejt e në Kaninë, ku u varros.

Në këtë mënyrë mori fund dhe ceremonia e varrimit.

28 nëntor 1932, ngrihet përmendorja e Ismail Bej Vlorës

Përurohet përmendorja e Ismail bej Vlorës në lulishten e madhe të qytetit të Vlorës. Sillen nga Kanina eshtrat e tij. Fjalën e hapjes e mbajti prefekti Abedin Nepravishta, i cili tha ndër të tjera “entuziazmi i popullit të Vlorës kapërcen çdo kufi duke parë përjetësimin e kujtimit të veteranit Ismail Qemali me ngritjen e një përmendorje nga N.M.T. Mbreti i Shqipëtarëve”.

Nga sheshi i Flamurit, kortezhi u nis për në Kaninë, ku pasi u hap varri u nxor prej andej trupi pjesërisht i tretur, u fotografua në shumë pamje dhe u vendos në një arkivol të posaçëm. U bënë shumë fotografi me Flamurin e parë të pavarësisë që plaku patriot kishte ngritur në Vlorë e më pas flamuri iu dorëzua prefektit nga Et-hem beu, djali i vogël i Ismail Qemalit, për t’ia dorëzuar ministrit të Arsimit me qëllim që të vendosej në muzeun kombëtar. Kur arkivoli mbërriti në Sheshin e Flamurit, përfaqësuesi i Mbretit, Gjeneral Giraldu zbuloi përmendoren. (gazeta “Besa” – nëntor 1932)

(Marrë nga gazeta “TELEGRAF”)

LIBRI

Një botim i ri me krijime të reja, të arrira artistikisht

“Rizgjime meteorësh”, libri i 13-të i Halil Ramës

Dr. Selman Mëziu*

Të hedhësh në letër vargje poetike, të shkruash një reportazh, të krijosh një portret të një njeriu me bëma të shumta, qoftë ky shkrimtar, ushtarak, artist etj., t’i futesh punës për të shkruar një recens (vlerësuese) të një libri artistik, i çfardo gjedhi qoftë, duhet më parë të kesh qenë nxënës studioz, më pas të bëjsh një jetë intensive për të njohur në thellësi e gjërësi realitetin shoqëror, historik, të natyrës; botën e brendshme dhe psikologjinë e heroit tënd, shoqëruar me leximin e librave, dokumentave e duke rrokur motive gjurmëlënëse në jetën e përditshme.

Një realizim të tillë dinjitoz e ka arritur shkrimtari dhe gazetari Halil Rama, i cili ka hedhur tanimë për t’u lexuar nga bashkëkombasit e tij 12 libra me bashkëautor ose i vetëm, si monografi, libra me shkrime të ndryshme me karakter historik, letrar apo të fushës së gazetarisë. Duke fituar një popullaritet të gjërë, një respekt të pakufishëm dhe rrezatuar trimëri, guxim, edukatë, kulturë të gjërë ka përthithur lexues të shumtë, për të lodruar me plotë dëshirë në polenin e krijimtarisë së tij plotë ambëlsi e kërshëri.

Ky krijues nuk resht së befasuari ato me krijimtari të reja më të arrira artistikisht, siç është libri i tij më i freskët i titulluar: “RIZGJIME METEORËSH”, ku edhe këtu në lëndën e derdhur mjeshtërisht me një krenari krijuese në mushtën e kapitujve të mëposhtëm: “Takohemi për një libër”; “Dibra dhe dibranët në panteonin e vlerave”; “Personalitete” dhe “Poezi të shkurtëra të çastit por kuptimplote e emocionuese”...., krijim pas krijimi, rrjesht pas rrjeshti gjendet adhurueshëm personaliteti i tij krijues, talenti i të shkruarit qartë e thjeshtë, njohuritë e tija, të thella e shumëplanëshe, mprehtësia e mendimit, mjeshtria e përshkrimit dhe gjetjes së detajeve, stili vetiak i të shkruarit, i të treguarit të ngjarjeve apo “vizatimit” të portreteve, duke përdorur një gjuhë të pastër, të rrallë, me fjalë të dalura nga gurra e pashtershme e librit të jetës dhe të lexuar, materialeve historike, gjuhës popullore mbarëkombëtare dhe e krahinës së Dibrës.

Me frymëzim dhe i prekur thellë në shpirt autori shkruan me plotë emocione, dhimbje, krenari të ligjshme për Heroin – legendë në kufirin e tri kohëve, gjeneralin shekullor Rrahman Parllaku. Me një stil të veçantë autori shkruan profilin e Safet Zhulalit si Ministër me karakter të papërthyeshem e largpamës, i cili ishte dhe mbeti një meteor në politikën shqiptare.

Kureshtësia në lexim do t’iu befasojë me analizën që i bëhet librit të diplomatit të mirënjohur, Shaban Murati, “Kalvari diplomatik i shtetit të Kosovës”, i cili në një libër tjetër e “Konsideron çështjen e detit si një nga dosjet më enigmatike të marrëdhënieve midis Shqipërisë dhe Greqisë”.

Më tej të nxit të lexosh me plotë kërshëri librin e Hysen Dervishit “Dibra, zemra e kombit” për të cilin Halili shkruan: “Ka shprehur mjeshtërisht ngjarje e fakte që flasin për luftëra e individë, për figura politike e patriotike që kanë bërë historinë përmes mendjes dhe pushkës...”

Në karvanin e vlerësimeve autori i librit shkruan për monografinë: “Burri i Odës Dibrane”, kushtuar Hazis Ndreut, rapsodit, mbledhësit të folklorit, historianit etj, të cilin e vlerëson: “... si një

Me frymëzim dhe i prekur thellë në shpirt autori shkruan me plotë emocione, dhimbje, krenari të ligjshme për Heroin – legendë në kufirin e tri kohëve, gjeneralin shekullor Rrahman Parllaku



libër shumëvlerësh, të stilit dhe llojit të veçantë, të autorit Bujar Kapexhiu, “Mjeshtëri i Madh”, artist i merituar, regjisor, skenarist dhe aktor i mirënjohur shqiptar”.

Një vend të veçantë në librin e ri të H.Ramës zë analiza e romanit “Martesa e dytë” të autorit Flamur Buçpapajt, ku ndër të tjera shkruan se: “Ka skali-tur veçanërisht portretet e Borës dhe Jetonit, por personazhe interesantë janë edhe nënë Ajshja, magjistarja Bukuri-je, Naimi, shoku i ngushtë i Jetonit, murgeshat si dhe motra e vogël e Borës”.

Po ashtu, autori ndalet tek romani “Polakja” të shkrimtarit të mirënjohur Xhevat Mustafa i cili “mbart vlera për koherencën dhe mesazhet aktuale”.

Për romanin e parë të shkrimtarit bulqizak Agim Demiri “Njeriu pa maskë”, përgjatë analizës së tij të hollësishme ai do të shkruaj: “... ky roman mbush një zbrazëti të dukshme në analet e letërisë shqipe”. Ndërsa duke u ndalur me kujdes e me dallgë frymëzmesh mbi librin me novela: “Pemë e shartuar”, të dibranit me banim në Kanada, Eliot Moglica, ai shkruan: “libër brilant”, “stil i ri letërar”, “autori i 16 librave me poezi, romane, biografi, tregime/novela dhe libra për fëmijë”.

Shkruesi i apasionuar Halil Rama, tanimë shkruan për një krijues tjetër në fushën e historiografisë dhe ja: “Pas tetë botimeve tematike për vlerat historike, kulturore dhe njerëzore, kryesisht për kryeqytetin shqiptar, studiuesi dhe analisti i mirënjohur Valter Gjoni sjell për lexuesin: “42 kryetarët e Tiranës, në një album fotografik dhe historik”. Një shërbesë e domosdoshme për njohjen e historikut të organizimit administrativ të kryeqytetit. Duke vazhduar me librin studimor “Qarku i Kukësit në rrjedhën historike”, i autorit Xhavit Lashi, i fokusuar tek ndarja administrative dhe qeverisja vendore në këtë qark, që nga lashtësia e deri në ditët e sotme..., duke ndjekur hap pas hapi veprimtarinë krijuese të Lashit, vlerësuesi shkruan: “... njëri nga ish-nxënësit e shkëlqyer të saj, historiani Xhavit Lashi botoi monografinë “Shkolla Pedagogjike e

Peshkopisë”, duke plotësuar një boshllëk në historinë e arsimit dibran me burime arkivore e një literaturë të pasur”.

Me tej autori analizon me kujdes librin në fushën e mjeksisë të Dr. Arjan Hamitit “Anemia në sëmundjet kronike të veshkave” i cili: “... do ndihmojë Mjekët e Familjes dhe specialistët në diagnostikimin e të sëmurëve me anemi...”.

Duke patur njohje të drejtpërdrejt me të ndjerin, shkrimtarin Teodor Laço, autori i librit, Rama do të shkruajë për të: “Si romancier, tregimtar, dramaturg, komedian, eseist, komentator, opinionist e politolog, ai padyshim njihet nga lexuesi shqiptar, por dhe ai i huaj...”.

H.Rama do të shkruaj me plotë frymëzim edhe për piktorin Alajdin Tabaku: “... i cili realizoi një seri peisazhesh dhe galeri portretesh me tipa e karaktere lakmuese që rrallë i gjen” si dhe për dibranin e mençur e vizionar Shuaip Methasani. Interesant është edhe profili i intelektualit Halit Berisha, i cili i përballoi me dinjitet sfidat e jetës.

Duke u ulur këmbë kryq me njerëzit e thjesht autori portretizon me mjeshtri, kujdes e depërtim psikologjik: “Vizionin e ushtarakut bashkëkohor dhe dimensione njerëzore Ruzhdi Baxhaku”. Dhe në vazhdim ai ndalet tek mesuesi Lutfi Ndreu i cili “..e ndjeu si shpirtëzohet dashuria në vetësinë e tij për nxënësit që materializohen si emisarë të dritës”. Më pas krijuesi energjik Rama, me një fushëpamje të gjerë në gjetjen e heronjve të tij, trajton emocionues: “Kosovare Rustemin nga Zhegra e Gjilanite vetmja deputete shqiptare në Asamblenë e Kantonit të Solothurnit të Zvicrës”. Ajo krenohet me vëllain e saj “Mjeshtri i Madh”, Erzen Rustemi, Kampion Bote në peshat e rënda të boksit.

Një vend të veçantë në libër zënë edhe kampionët e botës në kikkoks, vëllezërit bulqizakë Ismail, Gjetoan e Ferit Keta.

Duke qenë gjithmonë novator autori e trajton portretin e gazetares Mimoza Dajçi nëpërmjet librit të saj të ri “E buku-

ra nën pranga”, me reportazhe, skica letrare, esse e përshkrime. Lexuesi i zellshëm dhe i rrëmbyer faqe pas faqeje të këtij libri do të njihet me Elona Loparin, vajzën shqiptare, të suksesshme në Neë York, e cila ka për moto: “Unë nuk dua vetëm të mbijetoj, por edhe të vazhdoj të përpiqem për të arritur objektivat”.

Në portretizimin e të ndjerit, ushtarakut Selman Rama, shkruesi i librit “Rizgjime meteorësh” arrin në përfundimin: “Për katër dekada, karrierë si nxënës, student e oficer marine ai ka shpalosur vizionin e ushtarakut bashkëkohor dhe dimensionin njerëzor, të trashëguar nga Familja dhe të perfeksionuar gjatë punës e jetës ushtarake”.

Reportazhi “Bulqiza në 70 vite, minierë dhe qytet”, është një histori e analizë e thellë e veprimtarisë shtatëdhjetë vjeçare me “zhgënjime dhe emër”, me “heronj të rinj e të moshuar”, “me plagë vuajtjesh e djersë këllira prej pluhuri”. Më pas një trajtesë tjetër në gjedhin e reportazhit “Universiteti” ku studioi elita e Dibrës, i rrëfyer më së miri prej njërit nga mësuesit e parë të saj, shkrimtari Lutfi Hanku – një nga korifenjtë e vërtetë të kulturës dhe arsimit kombëtar në Dibrë”. Në vazhdim vlerat shëruese dhe burimet e të ardhurave të Ujërave termale, ose “Llixhat” e mirënjohura të Peshkopisë, duke u trajtuar me mjeshtëri gazetari, tanima plotësisht të maturuara.

“Historia e rrallë e familjes Gjonej nga Trushi i Shkodrës”, trajtohet nëpërmjet episodeve historike të rrëmbimit të Haxhelës, Krajlit të Malit Zi, letrës anonime dërguar Enver Hoxhës dhe përkujdesjes së Dr. Ben Gjonej për gjeneral Parllakun në spitalin e Traumës në Tiranë.

Dhe ja një degëz me frutin poetik: “Flakërima e shpirtit, djeg sa qindra zjarre”; këto janë disa shpërthime të momentit nga gurra poetike e Halil Ramës që mbyllin kurorën krijuese të librit të fundit.

Halil Rama, kryeredaktor i dy gazetave “Veterani” e “Bulqiza”, prej disa vitesh, ka konkuruar denjësisht në shtypin e kohës por ai ka botuar recensione në gazetën letraro-kulturore javore “NACIONAL” si edhe në suplementin “Milosao” të “Gazeta Shqiptare”. dhe Dhe jo vetëm kaq por në shtypin e kohës ai shkruan vazhdimisht artikuj me probleme të ndryshme të shoqërisë demokratike të kohës.

Gjerdani i krijimeve të librit “Rizgjime meteorësh” kamëron në hullitë e jetës me dashuri e drithërime të vrullshme, nëpërmjet rrëfimeve të shtruara, por të natyrshme dhe gjithë urtësi, mençuri e stil mjeshtërisht të gjetur, ku ngjizet mushti artistik me morinë e fakteve, ngjarjeve, detajeve historike, karakteret e ndryshme etj.

Lexuesit i urojmë udhëtim të mbarë, me plotë aromë poetike, artistike, emocionesh, kënaqësish në shfletimin e magjisë të personazheve, fakteve, ngjarjeve, historive, duke mësuar më shumë, duke u kulturuar e pasuruar me fjalësinë dhe mënyrën e të shprehurit, sjelljeve etj., ndërsa gazetarit e shkrimtarit Halil Rama, suksese të pashtershme në krijimtarinë e tij të plleshme e plotë bereqet.

SHENDETI

KARDIOLOGU LEONIDHA PEPPPO:

KUJDESI QË DUHET TË KENI NGA I FTOHTI DHE SISTEMI KARDIOVASKULAR

Dr. Leonidha Peppo

Në këto ditë shumë të ftohta të dimrit të ashpër paraqiten në spital, poliklinika e në regjim shtëpie, të sëmurë në gjendje të ndryshme shëndetësore, njerëz pa pasur sëmundje. Ato janë në moshë të ndryshme, që nga ata që preken më tepër si fëmijët apo të moshuarit, por edhe të tjerë ndërmjet kësaj moshe.

Por qëllimi i këtij artikulli është ti bëj me dije se çfarë pësojnë të sëmurët kardial, çfarë masash vetjake dhe ndihme mjeksore duhet dhënë nga personeli i kualifikuar, mjekë, ndihmësmjekë apo infermier, sidomos në zonat ku shërbimi është më i vështirë, apo atje ku nuk ka të tillë, ndonëse qeveria ka bërë oferta të mira, për ata që pranojnë të shkojnë në këto zona.

Por le të kthehemi tek tematika e këtij shkrimi: çfarë ndodh në të sëmurët kardiovaskularë në klima të ftohta, me lagështirë e temperatura të ulta?

Në këto kushte klimaterike të deritanishme, të këqija fillon e rritet tensioni i gjakut, shtohen të rrahurat e zemrës, frymëmarrja shpejtohet, qarkullimi i gjakut bëhet i vështirë, sepse enët e tij ngushtohen; pra këmbët mezi lëvizin, edhe truri që furnizohet pikërisht prej tij fillon e vuan duke shfaqur shenjat e asaj që quhet ishemi e trurit, me pasojat e saj. Të rrezikuar janë ata që pijnë duhan, të sëmurët me diabet (sëmundja e sheqerit), me sëmundje kronike të mushkërive apo të veshkave.

Të fillojmë me sëmundjet e zemrës.

Ngritja e tensionit të gjakut rrezikon infarkt të zemrës dhe të trurit. Të rrezikuar janë edhe ata që vuajnë nga damarët sepse kërkojnë më tepër oksigjen dhe kjo gjendje nuk ua mundëson këtë.



Natyrisht kjo është më e rëndë. Tek ata që dikur vuajtën nga këto sëmundje shtohen rrahjet e zemrës dhe këto çojnë në insuficience kardiace; gjendje mjaftë e rëndë dhe e vështirë për t'u kuruar dhe ndjekur me sukses, që i sëmuri të bëjë jetë cilësore dhe të mbijetojë gjatë.

Kjo kërkon konsulta të vazhdueshme dhe qëndrim pranë mjekut, duke zbatuar këshillat e tij dhe duke marrë me rregull barnat e demonstruar për këtë sëmundje. Duhet përmendur që i ftohti sjell grip, bronkopneumoni, sëmundje të veshkave apo çrregullime të zorrëve, të cilat rëndojnë shëndetin e këtyre të sëmurëve me pamjaftueshmërinë e funksionimit të zemrës (koronareve), të cilët rrezikojnë infarkt të saj. Tashmë në klimë të ftohtë e me lagështirë të këta të sëmurë mund të kemi rëndim të gjendjes, duke rritur nevojat për oksigjen që nuk mjaftojnë në këto kushte. Këto kombinohen edhe me çrregullim të ritmit të zemrës që i shtohet rrezikshmërisë të vetë sëmundjes bazë, duke rrezikuar edhe jetën.

- *Kjo situatë kërkon konsulta të vazhdueshme dhe qëndrim pranë mjekut, duke zbatuar këshillat e tij dhe duke marrë me rregull barnat e demonstruar për këtë sëmundje. Duhet përmendur që i ftohti sjell grip, bronkopneumoni, sëmundje të veshkave apo çrregullime të zorrëve, të cilat rëndojnë shëndetin e këtyre të sëmurëve me pamjaftueshmërinë e funksionimit të zemrës (koronareve), të cilët rrezikojnë infarkt të saj*



Më shqetësues mbeten të ekzaminuarit me çrregullim të rrahjes të zemrës, sepse duke u rënduar akoma më tepër, janë më të ekspozuar ndaj goditjeve në tru nga klima e ftohtë dhe rrahjet e çrregullta të zemrës.

Pale të mendosh që të ketë kombinim të të gjitha këtyre sëmundjeve që janë të pranishme në moshat e përparura dhe më tepër kur kanë fatin e keq të kenë edhe diabet, që përveç rrezikut që ka vetë, rëndon edhe diagnoza e pranishme. Por duhet të ruhen edhe të sëmurët kronikë të mushkërive, të gatshëm të akutizohen në periudhat e ftohta.

Aty mungon oksigjeni normalisht, por duke shtuar edhe ftohjen e herëpash-

erëshme shtohet mungesa e oksigjenit dhe rëndon edhe organet e tjera. Në këto kushte gati janë të sëmurë edhe organet e barkut që çrregullojnë dhe bëjnë të vuajë gjithë trupin.

Pra të gjitha këto që thamë diktojnë rritjen e kujdesit, sigurisht duke siguruar e përdorur veshjet e ngrohta, të ditura nga të gjithë, por që duhen konsideruar rigorozisht. Po ashtu duhet bërë kujdes në kufizimin e daljeve jashtë banesave të ngrohta, të shoqëruar domosdoshmërisht me marrjen e rregullt të barnave të dhëna nga mjeku si dhe duke shtuar edhe zbatimin e këshillave të nevojshme.


Shembujt janë të shumtë e fatkeqesisht raste të rëndimit apo edhe fatale në klimën e ftohtë. Këto i përmendëm për të qenë vigjilent e jo për frikë.

Evitimi i rrezikshmërisë arrihet nëpërmjet rritjes së nivelit kulturor e mjekësor të popullatës, nëpërmjet ndjekjes të emisioneve të medias dhe lidhjes së ngushtë me mjekët.

Edhe konferenca vjetore e Shoqatës Shqiptare të Kardiologjisë jep kontributin e saj, me temat e shumta të trajtuara, specifike, ku ato pas nderhyrjeve kirurgjikale, si ato By-Pass, të koronareve apo të valvulave të diskutuara dhe mjekimi plotësues janë të domosdoshëm.

Në këtë situatë, paralajmërojmë sidomos të kenë kujdes duhanpirësit, të shëndoshët, nga dhjamosja, ushqimet me yndyrë shtazore, tensioni i lartë i gjakut, origjina familiare për sëmundje, diabeti, tipi i njeriut, por edhe ngarkesat psikologjike që janë të rrezikuar për t'u sëmurur dhe të marrin këshillat e duhura.

*Kardiolog, Poliklinika Nr.4, Tiranë



HOMAZH

LAMTUMIRË ZENEL MALIQ HOXHA

Dy muaj më parë (më 8 dhjetor 2018) ndërroi jetë veterani i Luftës Antifashiste Nacionallirimtare, Zenel Maliq Hoxha. Ai kishte lindur 92 vjet më parë në lagjen Krrash të Zall Dardhës të Dibrës.

Fëmija i katërt i Familjes së njohur të Maliq Hoxhës (me 5 djem e një vajzë), nip i Sheh Velisë emërmirë të Reçit, në moshë fare të re shfaqti urtësinë për pushtimin fashist të vendit dhe sapo iu bë thirrje u rreshtua partizan me forcat e Brigadës së IV-të Sulmuese.

Mori pjesë në të gjitha luftimet e kësaj brigade, por veçanërisht u shqua në luftimet për çlirimin e Tiranës. Për dy javë luftimesh të ashpra ai do të ishte pjesë e Brigadës së IV që i bënte presion të vazhdueshëm armikut mbi Tiranë nga ana e jugut dhe jugperëndimit si dhe kur një pjesë e forcave të saj vepronte në rrugën Tiranë-Elbasan.

Një goditje fatale në Rrugën e Barrikadave për pak sa nuk i mori jetën, por fati e deshi të mbetej i gjallë mes gërmadhave të një ndërtese të goditur e shembur nga artileria armike. Ato çaste ai përjetoi me dhimbje të thellë rënien heroike të kushuririt të tij, Shaban Hoxha, dëshmor i LANÇ.

Pas çlirimit të atdheut nga okupatori nazifashist ishte ndër ata që u mobilizua me forcat e Policisë së Shtetit, fillimisht në qytetin e Burrelit dhe më pas për disa vite në Postën e Policisë të lokalitetit të Muhurrit. Këtu ai zgjeroi rrjetin e shokëve e të miqve, duke fituar admirimin e tyre, falë mirësjelljes e përkushtimit qytetar. Ndërkohë njohu edhe bashkëshorten e tij, Xhemilen (Disha), me të cilën krijoi një familje të mrekullueshme.

Kushtet familjare e detyruan të largohesh nga Policia dhe të kthehej në vend-

lindje, pranë prindërve. Punoi për vite të tëra në punë të ndryshme të ish kooperativës bujqësore të Dardhës, duke qenë gjithnjë në pararojë dhe shembull frymëzimi për të tjerët. Madje përvoja e tij u përgjithësua në disa takime në rang rrethi si dhe rang kombëtar, nga funksionarë e pushtetarë të asaj kohe.

Me vështirësitë e kohës, rriti dhe edukoi me virtytet më të mira tre djemtë: Gëzimin, Rifatin e Hekuranin si dhe vajzën e vetme shembullore, Minen.

Ai demonstronte sjellje të mira në shoqëri e në familje dhe për rrjedhojë gëzonte respektin e të gjithëve.

Pas vitit 2000 u vendos familjarisht në Paskuqan Tiranë, ku edhe këtu iu përkushtua maksimalisht Familjes dhe shoqërisë.

Deri në momentet e fundit të jetës pati përkujdesjen maksimale të djalit Gëzimit, nipit Shkëlzenit e bashkëshorteve të tyre të denja, përkujdesje



për të cilën ata meritojnë falenderim e mirënjohje Ndërkohë ai përjetoi çaaste të shumta gëzimi në praninë e nipave: Dik, Kurt e Olsi Daci si dhe të nipërve e mbesave të tjera të shumtë.

Zenel Maliq Hoxha u përcoll për në banesën e fundit me të gjitha nderimet që meritonte.

Parajsa qoftë vendbanimi i tij i përjetshëm!